



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në: “Inxhinieri Ndërtimi”
“Epoka University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm.

Fisnik KADIU

Gafur MUKA

Tetor/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Epoka University”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Epoka University
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 90, date 10.02.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA nr 201, dt 24.10.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër nr.286,dt 06.07.2012 VBA nr.48, dt 13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik /2 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe/ Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7(shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2021-2022:5 PAE/0 PAK v.a 2022-2023:5 PAE/0 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2021-2022: 1 student v.a 2022-2023:2 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti EPOKA ka filluar aktivitetin e tij me VKM Nr.28 datë 12.03.2008 në përbërje të të cilit funksionojnë 3 (tre) fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative; Fakulteti i Arkitekturës dhe i Inxhinierisë dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.

Programi i studimit Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimi, ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, në përputhje me ligjin 9741, datë 21.05.2007 të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Vendimi nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë". Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me qëllimin e objektivat e tij dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë dhe të tregut të punës.

Ky program studimi, është licensuar me VKM Nr.90. datë 10.02.2010. Ka realizuar akreditimin e parë me Urdhër Nr. 280, datë 06.04.2012; ndërsa akreditimin periodik me VBA datë 13.07.2018. Kohëzgjatja e PS është 2 vite akademike me 120 kredite, gjuha e zhvillimit të programit të studimit është gjuha angleze.

Për plotësimin e kërkesave të këtij programi të studimi, departamenti ka rekrutuar staf mësimdhënës me pedagogë me eksperiencë profesionale të huaj, nga Turqia dhe nga Shqipëria.

Infrastruktura bashkëkohore e Universitetit EPOKA ka siguruar për stafin dhe studentët e tij auditore, laboratore, biblioteka, zyra etj., me një përmbajtje cilësore të lartë, që i përgjigjen kërkesave që ka shtruar sot koha; të domosdoshme për zhvillimin normal të programit të studimit Master profesional në Inxhinieri Ndërtimi. Stafi akademik dhe ai ndihmës i Universitetit EPOKA mbështet studentët në vendimarrje në të gjitha nivelet dhe stimulon kontributin e tyre për arritjen e objektivave të studimit, duke garantuar barazi dhe transparencë në të gjitha nivelet edhe për cilësinë e mësimdhënies.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

ASCAL ka përcaktuar afatet dhe grupin e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Ndertimi, profili “Strukturë”. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u krijua nga ASCAL dhe përbëhet nga Prof As. Gafur Muka, Prof As. Fisnik Kadiu dhe koordinatori teknik e ASCAL, znj. Alma Arapi.

Nëpërmjet koordinatores teknike të ASCAL, Grupit të Vlerësimit të Jashtëm i janë vënë në dispozicion materiale udhëzuese për funksionimin e grupit, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e antarëve të grupit për t’u fokusuar në vlerësimin e standardeve dhe plotësimin e kriterëve të programit të studimit në Universitetin EPOKA.

GVJ, mbështetur në udhëzimet e ASCAL, hartoi një plan pune për siguruar të gjitha informacionet e nevojshme gjatë vizitës vlerësuese në Institucion si dhe afatet për realizimin e tij. Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ, ka hartuar një seri pyetjesh, të cilat kanë ndihmuar në qartësimin e disa çështjeve që lidhen edhe me përgatitjen e draf raportit.

Sipas planit, GVJ duke u ndihmuar edhe nga stafi mbështetës i institucionit organizoi takime sipas programit të përcaktuar dhe grumbulluar materialet e nevojshme, të cilat janë paraqitur në raportin e mëposhtëm, kryesisht për vitin akademik 2023-2024.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është përpjekur të bëjë një vlerësim objektiv të të gjitha kërkesave të çdo standardi dhe kriterëve të tyre të paraqitura më poshtë, duke u bazuar në synimin që institucioni të rrisë cilësinë dhe performancën për këtë program studimi në të ardhmen.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.48 datë 13.07.2018janë:

Institucioni duhet të shohë mundësinë e rishikimit të disa lëndëve me zgjedhje në favor të lëndëve aplikative dhe profesionale, duke patur parasysh nivelin e këtij program si Master Profesional dhe fushën e punësimit të studentëve në inxhinieri dhe kantjere.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Rekomandimi është përmbushur plotësisht, pasi programi lëndor i Master Profesional në “Inxhinieri Ndertimi” është përditësuar duke bërë rishpërndarjen e lëndëve dhe krediteve sipas llojit të aktivitetit, duke rritur përqindjen e lëndëve të detyrueshme dhe ulur përqindjen e lëndëve me zgjedhje. Raporti për veprimtaritë formuese A dhe B përbën 50% të peshës totale të planit mësimor.

GVJ, mendon se rekomandimi i Bordit të Akreditimit është përmbushur plotësisht.

Universiteti "EPOKA", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 137 / 3 Prot, datë 14.10.2024. Universiteti "EPOKA", njofton në ASCAL më datë 18.10.2024, me anë të shkresës me Nr.140/7 Prot, datë 18.10.2024 " Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi", i ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është në përputhje të plotë me misionin e Universitetit EPOKA (<i>Aneks 1</i>). Nëpërmjet programit të këtij studimi synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe përgatitjen e specialistëve të kualifikuar profesionalisht në fushën e teknikave të inxhinierisë së ndërtimit, në përputhje me standardet Evropiane. Programi i studimit synon kualifikimin dhe ngritjen profesionale të studentëve në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe ruajtjen e identitetit institucional për lrijimin e një mjedisi të sigurtë dhe të qendrueshëm që i dedikohen ruajtjes dhe promovimit të vlerave kombëtare akademike e kulturore shqiptare. Këto të dhëna GVJ i verifikoi gjatë vizitës në IAL, ku vlerësoi se ato i plotësojnë standardet për këtë program studimi. <i>Referenca:</i> Aneks 1(Statuti i Universitetit EPOKA)
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	GVJ, konfirmon se program i studimit është hartuar në përputhje dhe në zbatim të misionit të "Statutit të Universitetit EPOKA" (<i>Aneksi 1, Statuti U EPOKA</i>) dhe "Plani Strategjik i Universitetit EPOKA" (<i>Aneksi 9, Plani Strategjik i Universitetit EPOKA</i> " viti 2018-2022),

institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	në të cilin theksohet në rritjen e numrit të individëve social, të kualifikuar, produktivë dhe profesionistëve të përgjegjshëm dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare duke kontribuar në ngritjen e cilësisë së jetës shoqërore bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale. Misioni i institucionit është “ofrimi i programeve të studimit me karakter profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe teknikave e shkencës së materialeve e strukturave të ndërtimit të lidhura me të”.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Nisur edhe nga kërkesat e tregut të punës vendas, por edhe kërkesat e vendeve të huaja për specialist në fushën e ndërtimit, GVJ mendon se edhe misioni i departamentit që menxhon këtë program studimi (<i>Aneksi 10, “Plani Strategjik I Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit”</i>) është i konceptuar dhe zhvilluar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të Universitetit EPOKA dhe i hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të arsimit të lartë në vendin tonë dhe me protokollin evropian të Bolonjës dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve. Ky program studimi mendojmë se nxit zhvillimin lokal e kombëtar sepse është në plotësim gjithnjë edhe më shumë të kërkesave të tregut vendas dhe të huaj. Përgatitja e këtyre studentëve me nivelin e kërkesave që shtron sot koha në fushën e materialeve novatore, të projektimit e të teknologjive të reja të ndërtimit, u mundëson atyre edhe njohuritë e nevojshme për një kualifikim të mëtijshëm në programet e ciklit të dytë, që këto studentë mund të vazhdojnë në të ardhmen. GVJ, mendon se programi i studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi” ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe është në përputhje të plotë me fushën akademike të Universitetit EPOKA <i>Referenca, Aneksi i (Statuti I Universitetit EPOKA; Aneksi 9(Plani Strategjik i Universitetit EPOKA 2018-2022).</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin	Programi i studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi” (https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program) është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit duke synuar në përafrimin e tij me prioritetet e vendit tonë. Në stadin aktual të zhvillimit të vendit dhe të transformimit të tij drejt sfidave të BE, në arsim, investimeve në ndërtim dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi, GVJ gjykon se ky program studimi, me një staf akademik dhe specialistë të aftë të fushës, bashkëpunues me institucione vëndase dhe të huaja, si dhe duke patur parasysh mbështetjen e biznesit, mendojmë se përgatit inxhinierë ndërtimi të aftë për plotësimin e

përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	nevojave të tregut vendas dhe të huaj; përfshirjen e studentëve në studime të thelluara akademike; kualifikime të vazhdueshme të specialistëve të fushës; integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor; kualifikim të vazhdueshëm të stafit akademik duke kontribuar në ngritjen e standardeve të mirëqënies dhe ndihmuar në zhvillimin ekonomik të vendit dhe atë rajonal. <i>Referenca: Aneksi 1(Statuti i Universitetit EPOKA, neni 3), Aneksi 49(Kurrikula e programit MP).</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Universiteti EPOKA ofron programin e studimit që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike, kulturore dhe kombëtare. Ky program është hatuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, duke u përshatur me statutin dhe rregulloren e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti EPOKA me një përvojë të gjatë 20 vjeçare demonstroi se gjatë kësaj periudhe ka përditësuar formimin e specialistëve të lartë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit duke u orientuar nga kërkesa bashkëkohore në mësimdhënie, infrastrukturës, burimeve njerëzore sipas standardeve evropiane të cilësisë. Nga vizita në IAL konstatohet se infrastruktura e IAL ka të gjitha kapacitetet e nevojshme logjistike dhe didaktike për të realizuar me sukses edhe në të ardhmen programin e studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi”. Kështu, për t’u përmendur janë Auditorët/Klasat e leksioneve, seminareve, biblioteka dhe laboratorët informatikë, përfshirë dhe laboratorin e testimit të materialeve dhe të provave të strukturave të ndërtimit, si një nga qendrat eksperimentale më të mira në IAL të profilit të inxhinierisë së ndërtimit në vendin tonë; Zyra e informimit të Studentëve, Zona sociale dhe Sportive; Mjedise për personelin si Zyra, salla takimi, ambiente recreative, etj.(Aneksi

	67, <i>Infrastruktura në funksion të priogramit të studimit</i>). Gjatë vizitës në institucion GVJ, konstaton se për vitin akademik 2023-2024 është angazhuar një personel akademik i huaj dhe vendas me përvojë i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi (<i>Aneksi 5, CV të stafit akademik dhe Aneksi 80 (Të dhëna për personelin akademik/ Tabelat 2; 2.1; 2/2; 2.3 dhe 2.4)</i>, që tregon se institucioni ka burime dhe kapacitete për ofrimin e këtij programi studimi. Në shërbim të këtij programi një suport të rëndësishëm japin dhe Shërbimet ICT (<i>Shërbime mësimore si Turnitin, LMS, Koha DSpace</i>), Shërbimet Google, Epoka Interactive Systems-EIS; Sistemi i Informacionit Arsimor (<i>Plani mësimor</i>); Smart Card, Help Desk, Softëare, Netëork. <i>Referenca: Aneksi 67(ICT, Infrastruktura në funksion të programit të studimit)</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit në “Inxhinieri Ndërtimi” janë në përputhje me fushën kërkimore, shkencore dhe atë akademike të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Universitetit EPOKA. kryesore përgjegjëse (<i>Aneksi 1, “Statuti i Universitetit EPOKA</i>). Fakulteti është njësi kryesore akademike e U EPOKA, i cili koordinon mësimdhënien kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor (<i>Aneksi 16, Skema Organizative e Universitetit EPOKA</i>), https://epoka.edu.al/home-staff-organization-scheme-6-46.html). Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit është njësi bazë që koordinon programin e studimit MP në Inxhinieri Ndërtimi. Universiteti EPOKA është në proces të miratimit të kodifikimit të të gjitha programeve të studimit që ofrohen aktualisht në të tre ciklet e studimeve në përputhje me përcaktimet e nenit 86 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë”, Vendimi i Keshillit të Ministrave Nr.10, datë Lëndët dhe programet e studimit në tërësinë e tyre janë të kodifikuara sipas dispozitave të nenit 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencorë” në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” si dhe udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.31, datë “Për procedurat në lidhje me kodifikimi e

	programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Referenca: Statuti i Universitetit EPOKA, Shënime nga vizita në institucion.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e studimit të programi të studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Universitetit EPOKA. Programi i studimit në Master Profesional, sipas kornizës së kualifikimeve shqiptare, klasifikohet si një kualifikim i nivelit 7. Ky departament jep diplomë universitare në nivelet Bachelor, Master dhe Doktoraturë në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit të arsimit të lartë në Shqipëri dhe me Procesin e Bolonjës në Evropë dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Kredive.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	GVJ, konstaton se ky kriter i këtij standardi nuk aplikohet në këtë program studimi. Marrëveshjet me institucione partnere të arsimit të lartë, pjesë e Strategjisë, janë të fokusuara në ofrimin e njohjes reciproke të planit mësimor për të lehtësuar lëvizshmërinë në kuadër të shkëmbimeve të financuara nga BE.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Universiteti Epoka ka organizuar konferenca dhe ofruar trajnime profesionale me ekspertë vendas dhe të huaj. Nga ana e tij Departamenti i mundëson këto trajnime edhe për studentin aktualë dhe atyre të diplomuar ndër vite. Për t’u vënë në dukje është organizimi nga Universiteti Epoka i Konferencës Ndërkombëtare “Sfidat në Ballkanin Perëndimor; Infrastruktura dhe Zhvillimi në Rajon”; GVJ këto të dhëna i verifikoi sipas të dhënave nga dokumentacioni GVB por edhe nga bisedat e zhvilluara me studentin e stafin akademik gjatë vizitë vlerësuese. <i>Referenca: Aneks 95 (Plani i aktiviteteve).</i>
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Institucioni disponon kapacitetet dhe burimet e nevojshme në fushën akademike për ofrimin e këtij programi sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane, e cila garantohej edhe me bashkëpunimin me institucione partnere.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimi profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Programet e studimit në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, synojnë një nivel të krahasueshëm me diplomat e fakulteteve jashtë vendit, programe të cilat janë hartuar në përshtatje me nevojat e shoqërisë shqiptare, kushtet aktuale dhe perspektivat e zhvillimit të vendit tonë. Stafi akademik përbëhet nga lektorë vendas dhe të huaj. Çdo vit institucioni realizon matjen e Cilësisë në Arsimin e Lartë bazuar në treguesit e standardeve shtetërore; nëpërmjet vlerësimit të programeve të studimit, verifikimit dhe modifikimit të kurrikulave, planeve mësimore dhe moduleve të caktuara. Njësitë administrative mësimore-kërkimore (departamentet) dhe njësitë kryesore (fakultetet) koordinojnë veprimtaritë e njërive bazë për mirëmbajtjen e infrastrukturës, pranimin, marrëdhëniet ndërkombëtare, sigurimin e cilësisë dhe porojektet. Institucioni nga ana e tij është garanti i kësaj marrëdhënie nëpërmjet ndarjes së detyrave të stafit dhe përmbushjes së tyre. <i>Referenca: Aneksi 1(Statuti i Universitetit EPOKA, (https://epoka.edu.al/mat/legalacts/Statute_Uni_EPOKA_en.pdf))</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Përvoja e Universitetit EPOKA është e pasur sa i takon marrëveshjeve të bashkëpunimit me një numër të konsiderueshëm institucionesh si brenda ashtu dhe jashtë vendit (https://epoka.edu.al/membership/lcat-partnerships-2322.html); që për këtë program studimi përfaqëson një objektiv strategjik të Universitetit EPOKA (Aneksi 17, <i>Plani Strategjik për ndërkombëtarizimin</i>). Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në varësi të Rektoratit koordinon mobilitetet dhe projektet me universitetet evropiane nëpërmjet Programit ERASMUS+ dhe marrëveshjeve dy palëshe (Aneksi 52 <i>"Lista e marrëveshjeve me partnerët e huaj në funksion të programit të studimit"</i>). Mobilitetet kanë ofruar mundësinë e shkëmbimit të dijeve dhe nxitjen në mësimdhënie dhe mësimnxënie (Universiteti EPOKA është i pari institucion privat që ka përfutuar nga program TEMPUS në Shqipëri, i financuar nga Bashkimi Evropian). Universiteti EPOKA vazhdon të jetë institucion partner në disa projekte Erasmus+KA2 për Ngritjen e Kapaciteteve dhe një projekti Horizon

	2020, është Koordinator i projektit Erasmus+ Jean Monnet (Aneksi 48, Lista e Projekteve Kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel Departamenti/Fakulteti të fituara dhe zbatuara, që nga periudha e akreditimit të fundit. Universiteti EPOKA është anëtar i asociuar i Shoqatës së Universiteteve Evropiane (EUA), një nënshkrues i Magna Charta Universitatum, Parimet e Inisiativës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin e Menaxhimit të Përgjegjshëm dhe Yunus Centre, Dhaka. Universiteti EPOKA bashkëpunon me institucione joarsimore për udhëheqje të studentëve në praktikat profesionale dhe mundësitë e karrierës. <i>Referenca: (Aneksi 52, Lista e Marrëveshjeve të partneritetit në funksion të programit të studimit); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik.</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Universiteti EPOKA ka marrëveshje bashkëpunime me punëdhënësit në sektorin publik dhe privat brenda vendit. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve janë krijuar kushte e mundësi për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve (Aneksi 80, pasqyra nr.5 "Marrëveshjet e Partneritetit në funksion të programit të studimit). Universiteti EPOKA kryen trajnime profesionale duke ftuar specialist të fushës (Aneksi 95, Kalendari vjetor i aktiviteteve) nëpërmjet të cilave realizohen leksione të hapura, forume, konventa dhe udhëtime studimore. Gjithashtu, për partneritetin me jashtë aktiviteti i Universitetit EPOKA është mjaft efektiv. https://ce.epoka.edu.al/neës-open-lecture-ëith-prof-marco-corradi-repair-and-reinforcement-of-historic-masonry-structures-4765.html, https://ce.epoka.edu.al/neës-civil-engineering-department-organized-the-4th-international-balcans-conference-on-challenges-of-civil-engineering-4bcce-5434.html <i>Referenca: (aneks 52, Lista e marrëveshjeve të partneritetit me jashtë në funksion të programit të studimit).</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia	Për analizën e ecurisë së programit të studimit Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit diskuton dhe harton raporte periodike për të

përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	analizuar arritjet dhe problematikat, përcakton objektiva midis tyre edhe ato që kanë lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit. Raporti vjetor (Aneks 56, Raporti Vjetor 2021-2022) përshkruan në detaje përfitimet e marrëveshjeve me institucionet kombëtare e ndërkombëtare nga Zyra e hulumtimit të projekteve; përfitimet për mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik nga Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe punësimin e studentëve të diplomuar nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve. <i>Referenca: (Aneks 56, Raporti Vjetor 2021-2022); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Universiteti EPOKA ka marrëdhënie shumë të mira bashkëpunimi si brenda vetë institucionit dhe aktorëve të biznesit po ashtu edhe të bashkëpunimit me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucioni synon që edhe në vitet e ardhshme të zgjerojë bashkëpunimin me institucione universitare evropiane dhe më gjerë në kuadër të mobiliteteve të projektit Erasmus Plus.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në	Programi i studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi”, është bazuar në rregulloren e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe përputhet plotësisht me misionin e Universitetit EPOKA. Ai përmbush edhe detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë. Programi i studimeve është në përputhje të plotë me Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët

përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë “të ndryshuar. Bazohet në module, lëndë të kategorizuara në bazë të veprimtarisë formuese, të ndara në lëndë kryesore, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Janë 60 Kredite ECTS për vitin akademik, të karakterizuar sipas lëndëve. Gjuha e mësimit është anglishtja. Programi përputhet me objektivat e Nivelit 7 të AQF. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Në kategorinë A bën pjesë 1 lëndë (7.5 kredite), në kategorinë B bëjnë pjesë 3 lëndë (22.5) kredite), në kategorinë C bëjnë pjesë 2 lëndë (15 kredite), në kategorinë D bën pjesë 1 lëndë (7.5 kredite) dhe në kategorinë E bën pjesë 1 lëndë (7.5 kredite). Bazuar në tabelën Nr.9 (Shpërndarja e aktiviteteve, viti akademik 2023-2024, kreditet përkatëse të lëndëve sipas kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje, e shprehur në përqindje: • kategoria A- 12.5 %, • kategoria B- 37.5 %, • kategoria C- 25.0 %, • kategoria D- 12.5 %, • kategoria E- 12.5 %. Nga sa më lart përqindja e shpërndarjes së lëndëve të kategorive A, B, C dhe D rezultojnë me shpërndarje normale. (<i>Aneks 96, Kurrikula e ndryshuar e programit të studimit MP në Inxhinieri Ndërtimi</i>); (<i>Tabela 9, Shpërndarja sipas aktiviteteve formuese të Kurrikulës</i>). <i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose	Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” është i fokusuar në objektivat për formimin teorik dhe praktik të studentëve me njohuri, aftësi dhe kompetenca për t’u përballur me sfida komplekse në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. <i>Njohuritë</i>, që studentët marrin janë të natyrave të ndryshme si p.sh.ato të komunikimit akademik, të menaxhimit, përsosja e mëtejshme e gjuhës angleze profesionale; <i>Aftësitë</i>, ky program, është i fokusuar në kualifikimin profesional e shkencor të specializuar në fushën e inxhinierisë së ndërtimit; <i>Kompetencat</i>, studentët fitojnë përgjegjësi nëpërmjet përvetësimit të teknikave të reja digjitale të programeve të llogaritjes të strukturave të ndërtimit dhe metodave për testimin e materialeve

profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	dhe provave të strukturave ndërtimore. Shpërndarja e orëve mësimore e pasqyruar në ndarjen e krediteve është e organizuar në mënyrë të tillë që ruan raportin teori/praktikë.
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi është i organizuar sipas sistemit evropian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve ECTS. Ai realizohet në 1 (një) vit akademik, i ndarë në 2 (dy) semestra me 60 kredite ECTS në total. Programi i plotëson kërkesat dhe elementët e parapara nga ligji dhe aktet e tij nënligjore. Mjediset për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe laboratorët janë të plotësuar me pajisje, softëere dhe aparatura testimi të nivelit bashkëkohorë. Programi përmban 8 lëndë, 6 lëndë të detyrueshme dhe 2 lëndë me zgjedhje (60 kredite) dhe provimi përfundimtar (diploma) me 7.5 kredite. Praktika mësimore ka një ngarkesë të përcaktuar prej 7.5 kredite ECTS dhe është detyruese përpara se të mbrohet diploma. <i>Referenca: https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	NA
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.	NA

Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Organizimi i studimeve të këtij program studimi është në përputhje të plotë me VKM Nr.41, datë 24.01.2018, të ndryshuar, referuar elementëve përbërës të programit të studimit për secilin cikël të studimit, tipeve të komponentëve dhe programit të lëndëve. Universiteti ndjek një politikë të hapur për pranimin e studentëve vendas dhe të huaj. Politikat e pranimi janë përcaktuar në rregulloret bazë dhe akte të tjera të brendshme, udhëzim i brendshëm Nr.12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në arsimin e lartë”. <i>Referenca: Rregullore e përgjithshme</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimi (cikli i dytë) ofrohet në të njëjtën fushë studimi, me përmbajtje të ngjashme dhe të njëjtin emërtesë. Nga takimi me stafin e këtij program na u konfirmua një gjë e tillë. Me përfundimin e studimeve studentët pajisen me Diplomë, e cila ju mundëson të pajisen me licensë profesionale si Inxhinier ndërtimi zbatues nga Ministria e linjës.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit në “Inxhinieri Ndërtimi” është në proces të miratimit të kodifikimit referuar fushës së studimit, ndërsa lëndët që përbëjnë këtë program studimi janë të kodifikuara. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Në kategorinë A bën pjesë 1 lëndë (7.5 kredite), në kategorinë B bëjnë pjesë 3 lëndë (22.5) kredite), në kategorinë C bëjnë pjesë 2 lëndë (15 kredite), në kategorinë D bën pjesë 1 lëndë (7.5 kredite) dhe në kategorinë E bën pjesë 1 lëndë (7.5 kredite). Bazuar në tabelën Nr.9 (Shpërndarja e aktiviteteve, viti akademik 2023-2024, kreditet përkatëse të lëndëve sipas kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje, e shprehur në përqindje: • kategoria A- 12.5 %, • kategoria B- 37.5 %,

	• kategoria C- 25.0 %, • kategoria D- 12.5 %, • kategoria E- 12.5 %. Nga sa më lart përqindja e shpërndarjes së lëndëve të kategorive A, B, C dhe D rezultojnë me shpërndarje normale. (Aneks 96, Kurrikula e ndryshuar e programit të studimit MP në Inxhinieri Ndërtimi); (Tabela 9, Shpërndarja sipas aktiviteteve formuese të Kurrikulës). <i>Referenca: Kurrikula e programit të studimit; Tabela 9, Plani mësimorë i ndarë sipas veprimtarive Formuese (A-E); Shënime të mbajtura nga vizita në Institucion; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NA			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Strukturat e Programit të studimit të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar në përputhje me legjislacionin vendas dhe systemin evropian të Transferimit e Grumbullimit të krediteve (ECTS). Ky program studimi përvetëson teorinë dhe parimet akademike të fushës të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse në aplikimin e tyre praktik. Programi i studimit në Inxhinieri Ndërtimi është në proces të miratimit të kodifikimit të programit të studimit nga Institucioni përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse	Fakulteti Arkitekturës dhe Inxhinierisë në përbërje të tij ka tre departamente dhe një qendër kërkimore. Programi i studimit Master

për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” bën pjesë në Fakultetin e “Arkitekturës dhe Inxhinierisë” me dekan Prof. Dr. Sokol Dervishi, ndërsa drejtimi i këtij programi ofrohet në përgjegjësinë e “Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit” me përgjegjës Prof. asoc. M.Ndini. Institucioni në departamentet e tij ka të aktivizuar Personel Akademik me kohë të plotë (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) dhe Personel ndihmës akademik, sim ë poshtë:

Tituj/grada	2023-2024	
	PAE	PAK
Prof.Dr	6	1
Prof.As.Dr	4	1
Dr/PhD	15	2
Msc	19	16
Në total	44	20

Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit përbëhet nga

Tituj/grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	2	1	2	-
Prof.As.Dr	1	-	1	-
Dr/PhD	3	2	4	-
Msc	1	2	1	2
Në total	7	5	8	2

	Rreth 83% e ngarkesës mësimore mbulohet nga personeli akademik me kohë të plotë ndërsa rreth 17 % e ngarkesës nga stafi akademik me Kontratë. Të drejtat dhe përgjegjësitë e çdo njësie janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit. <i>Referenca: Aneksi 80, Tabela 1 &2 (Personeli akademik me kohë të plotë dhe i ftuar); Aneksi 16 (Organigrama e Universitetit EPOKA); Raporti RVB; Shënime nga vizita në Institucion; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Programi studimit përmbush detyrimet për numrin dhe kualifikimin e stafit akademik. Sipas RVB dhe nga takimet në institucion, Departamenti Inxhinierisë së Ndërtimit në mësimdhënie aktivizon personel aktiv me kohë të plotë (PAE): (2) Prof. Dr.; (1) Prof. Asoc.; (4) Dr; (1) MSc. dhe (2) M.Sc. asistentë, ndërsa PAK janë (2) Msc; duke plotësuar kështu edhe detyrimin ligjor për numrin minimal prej 7 (shtatë) pedagogë efektiv; Neni 25 i ligjit 80/2015. Sipas vendimit të KM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; Universiteti EPOKA ka emëruar drejtuesin e departamentit si kordinator të programit. Personeli akademik, që kryen mësimdhënien dhe mbikqyrje në MP në Inxhinieri Ndërtimi zotëron të paktën një gradë shkencore, është i trajnuar dhe i kualifikuar nga Universiteti EPOKA dhe është i angazhuar në mbarëvajtjen dhe organizimin e orëve mësimore. Me propozim të Departamentit dhe me vendim të Komitetit shkencor për studentët caktohen këshillues mësimor, të cilë udhëzojnë studentin për lëndët që ai duhet të bëjë zgjedhje. Këshilluesi është pedagog i Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe zotëron të paktën gradën shkencore Doktoraturë, (Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimeve të Ciklit të dytë).
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe	Përgjegjës për zhvillimin, ecurinë dhe mbarëvajtjen e objektivave të programit të studimit, departamenti ka caktuar koordinator të këtij program studimi Asoc.Prof. Dr. Miriam Ndini. Për ecurinë e praktikave profesionale të studentëve për vitin akademik 2023-2024 është ngarkuar nga Departamenti si koordinator Dr. J. Keçi. Koordinator kryen takime të vazhdueshme me titullarin e njësise përkatëse, duke e informuar rregullisht për ecurinë e programit të praktikave profesionale

zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.				
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush detyrimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, për organizimin e strukturës akademike, si me personel akademik ashtu dhe me personel ndihmës akademik e administrative për realizimin e praktikave profesionale, duke caktuar një koordinator të programit të studimit me 18 kompanitë e kontraktuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë është njësia kryesore dhe përgjegjëse për informimin dhe organizimin e programit të studimit Master profesional në "Inxhinieri Ndërtimi". Plani mësimor (Tabela 11) përmban informacionin e nevojshëm mbi mënyrën e organizimit të programit të studimit (ce.epoka.edu.al); semestrat në të cilin zhvillohen lëndët, lektorët e moduleve, llojin, objektivat dhe kohëzgjatjen e modulit, kreditet e moduleve përcaktuar në ECTS, objektivat e modulit, metodat e vlerësimit, literaturën përkatëse, detyrimet e studentëve për çdo modul dhe detyrimet përmbyllëse. Plani mësimor është objekt i rishikimit në çdo vit akademik dhe pas diskutimeve të këtij plani, në department ai miratohet nga dekani i fakultetit. GVJ vlerëson rregulloren e programit të studimit, kurrikulën, planin mësimor, syllabuset e lëndëve dhe ndarjen e tyre sipas veprimtarive formuese. Lëndët janë të kategorizuara në: (A) Lëndë të formimit Bazë , të cilat japin përgatitjen metodologjike dhe formim të përgjithshëm me 7.5 kredite.; (B) Lëndë të formimit karakterizues , të formimit të përgjithshëm për disiplinën shkencore me 22.5 kredite dhe (C) Lëndë ndërdisiplinore/integruese , të ngjashme me lëndët plotësuese me 15 kredite; (D) Lëndë plotësuese nëpërmjet të cilave ndihmojnë në formimin e studentëve dhe aftësimin e tyre për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës, me 7.5 kredite. Këto informacione janë të disponueshme në faqen zyrtare të

	Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit (ce.epoka.edu.al) si dhe në “Planin Mësimor” në faqen kryesore të internetit të Universitetit EPOKA https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program <i>Referenca: Aneks 80 (Summary Tables, Curriculum of the study program MP in ce ëith profiles)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor specifikon gjithë informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit, ai është i publikuar dhe i aksesueshëm për publikun https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program. Llojet e lëndëve dhe pesha e tyre në planin mësimor janë në përputhje të plotë me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar. Përmbajtja e syllabuseve është e plotë duke patur detaje për vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda, emrin e titullarit të moduleve, llojin, objektivat dhe kohëzgjatjen e modulit, metodat e vlerësimit dhe literature e rekomanduar dhe atë të detyruar, përfshirë dhe detyrimet e studentit për çdo modul dhe detyrimet përmbyllëse. Programi i studimit (vit, semestër, javë) është i organizuar në dy semestra dhe ofron 8 (tetë) lëndë të shpërndara në dy semestra, me (7.5) ECTS për çdo lëndë. Numuri i krediteve ECTS llogaritet në bazë të ngarkesës së studentit, e përcaktuar në planin mësimor të këtij program studimi për vitin akademik 2023-2024. <i>Referenca: Aneks 80 (Tabelat përmbledhëse, Plani mësimor i programit të studimit MP në Inxhinieri Ndërtimi)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Mënyra e pranimit dhe seleksionimi i studentëve në programin e studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” është e përcaktuar në rregulloren e FAI. Institucioni vendos kriteret për pranimin e studentëve në zbatim edhe të udhëzimeve nga Ministria përgjegjëse për Arsimin e Lartë sa i përket mënyrës së aplikimit të studentëve. Departamenti i publikon në faqen e internetit të Universitetit EPOKA (ce.epoka.edu.al). GVJ, konstaton se Institucioni në rregulloren e tij ka paraparë edhe transferimin e studimeve në të njëjtin cikël studimesh, procedurat e transferimit si dhe ekuivalentimin e programeve të studimeve për studentët që transferohen. Programi i studimit parashikon edhe rregullat transferimet dhe ekuivalentimin e studimeve drejt IAL-ve të tjera https://epoka.edu.al/mat/directives/Directive_On_Student_Transfer.pdf (Aneks 37, Direktiva “Për transferimin e Studentëve). Gjatë takimit në institucion me studentin E. Skura na u konfirmua prej tij se informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e përgjithshme të pranimit, për lëndët,

	praktikat, seminarët dhe gjithë komponentët formues të programit të studimit kanë qenë të plota dhe të qarta. <i>Referenca: Aneks 7(Rregullore e Universitetit EPOKA" Per programet e studimeve të ciklit të dytë), Aneks 37 (Direktiva për Transferimin e Studentëve"</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Stafi akademik kryen detyra të rëndësishme për të siguruar dhe përditësuar informacione që kanë bëjnë me përmbajtjen e lëndëve të detyrueshme apo ato me zgjedhje në çdo semester. Studentëve, u bëhen të qarta programi i studimeve dhe përmbajtja e tij për ngarkesën e punës në auditor, frekuentimi dhe ndjekja e programit të lëndës (syllabusi), përfshirë dhe specifikat për secilën lëndë pa lënë mënjanë elementët e tjerë të programit si praktikat, ushtrimet, punët laboratorike etj. <i>Referenca: Aneks 5 (Programet lëndore); Forma Syllabusi, Raporti i Grupit të vlerësimit të brendshëm. Shënime nga vizita në Institucion.</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Institucioni, para fillimit të çdo viti akademik shqyrton të gjitha programet e studimit, në mënyrë që këto të jnë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Programi i studimit është i përshtatur dhe përputhet me nevojat e kërkesat e tregut të punës. Programi është hartuar edhe në përvojat dhe eksperiencat e shkollave më në zë për kurrikulat e studimit, që mundësojnë formimin e specialistëve të rinj në teknikat e kohës. Institucioni ofron trajnime të vazhdueshme për stafin akademik me qëllimin përmirësimin e syllabuseve. Kurrikula e programit rishikohet çdo vit, duke bërë ndryshime nëse vlerësohet e nevojshme, sipas përqindjeve të lejuara nga statuti i Universitetit EPOKA. Procedurat e rishikimit bëhen në bashkëpunim edhe me NJSBC (Aneks 80, Tabela përmbledhëse Nr.11; ndryshimet e planit mësimorë) dhe (Aneks 4, Vendim I Senatit Akademik për Mioratimin e Ndryshimeve të Planeve mësimore për MP në programin e studimit IN). Në disa raste kërkohet edhe asistencë teknike e personelit akademik në varësi të



	programeve të studimit, duke mundësuar kështu edhe unifikimin e formateve të syllabuseve në nivel institucional. <i>Referenca: Aneks 4 (Shëmbull i Vendimit të Senatit Akademik për Miratimin e ndryshimeve të Planeve mësimore për MP në Inxhinieri Ndërtimi; Aneks 19 (Për përmirësimin e Vazhduesahëm të Programeve të Studimit); Aneks 32 (Libri për sigurimin e Cilësisë Universitaqre EPOKA); Aneks 80 (Tabela përmbledhëse 11, ndryshimet e planit mësimor që nga akredimi i fundit); Aneks 90 (Formulari i propozimit për ndryshimin e planit mësimor).</i>			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit disponon informacionet e nevojshme për organizimin e strukturës dhe përmbajtjen e programit, sipas planit mësimor, ngarkesës mësimore/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit, etj. Ky program përmban informacionet e nevojshme për secilën lëndë (syllabuset), praktikat, seminarët, orët laboratorike në përputhje me formatet e miratuara dhe të përditesuara në çdo vit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Përmbajtja e Programit të Studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” ofron një bazë të mjaftueshme njohurish në fushën e teknikës së inxhinierisë së ndërtimit. Në përfundim të programit të studimit, të diplomuarit fitojnë kompetenca profesionale për tu përshtur në sektorë të ndryshëm pune si atë publik dhe privat. Programi është hartuar bazuar edhe në kërkesat e tregut të punës në vëndin tonë madje duke ju mundësuar studentëve punësim edhe në tregun evropian e më gjerë. Komponentët mësimorë janë në funksion të bashkëveprimit dhe interaktivitetit të studentëve dhe pedagogëve përkatës të lëndës në funksion të stimulimit të tyre krijues/novator dhe praktik. Lëndët janë të organizuara në mënyrë të tillë që ofrojnë një raport bindës ndërmjet thellimit të njohurive teorike dhe praktike ndërmjet tyre. Referuar lëndëve mësimore, programi i studimit ka treguar se arrin të përmbush objektivat

	formuese të programit studimor me rezultatet të kënaqëshme të të nxënit, mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. <i>Referenca: Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimi; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GVJ është i mendimit se programi i studimeve, përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë; njohuri, aftësi dhe kompetencë të studentëve dhe përmbushjen e objektivave akademikë të programit të studimit. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, vlerësimi në kredite dhe njohja e tyre edhe jashtë vendit, raporti teori praktikë justifikojnë rezultatet e pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik kontribuojnë në arritjen e kompetencave që ofron ky program studimi. <i>Referenca: Aneksi 5 (Programet lëndore); Shënime nga vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Plani mësimor është në përputhje me profilin e programit Master Profesional dhe i ndërtuar mbi përvojën më të mirë evropiane të programeve të studimit në Inxhinieri Ndërtimi. Gjatë vizitës dhe takimeve me stafin mësimor, GVJ konstaton se në shumë lëndë aplikohen detyra/projekte kursi me studentët për të siguruar aftësi, kompetencë dhe formim të thelluar profesional. Në rregulloren e programit të studimit janë të përcaktuara raportet e formimit teori-pratikë të formimit profesional të studentëve në plotësim të objektivave në tërësi të këtij programi. Gjuha e mësimimit është anglishtja dhe stafi i huaj i angazhuar është me përvojë ndërkombëtare. <i>Referenca: Aneksi 6 (Përfshirja e stafit ndërkombëtar si staf me kohë të plotë); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik.</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	Programi i studimit është organizuar duke konsultuar edhe programe të ngjashme ndërkombëtare. Syllabuset e planit mësimor të programit të studimit Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" parashikojnë kontrollin e dijeve të ndara nëpërmjet pjesëmarrjeve aktive në auditor, kryerjen e detyrave, provimeve të pjesshme dhe provimit përfundimtar. Konceptimi dhe ndarja mes veprimtarive formuese synon që studentët të kenë mundësi mobiliteti dhe transferimi të studimeve, të konkurojnë dhe të përshtaten denjësisht

mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	dhe punësimin e tyre në kushtet e tregut. Natyra e moduleve dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të pjesës teorike dhe praktike për çdo modul. <i>Referenca: Aneksi 49 (Plani mësimor i programit të studimit në Inxhinieri Ndërtimi. https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset janë ndërtuar në përputhje me ligjin dhe pasqyrojnë informacione mbi lëndën, objektivat, synimet dhe kompetencat, konceptet themelore, tematikat e përfshira, format e kontrollit të dijeve, literatura, etj. Ato përditësohen çdo vit (<i>Aneksi 19-Për përmirësimin e programeve të studimit</i>) duke mbajtur parasysh që literatura kryesore e mbështetëse të jetë e viteve më të fundit. Ofrimi i programit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” në gjuhën angleze ka lehtësuar adoptimin e saj në disipilinën inxhinierike. Gjithashtu, në rregulloren e programit të studimit është e përcaktuar që përmbajtja e lëndëve dhe moduleve duhet të garantojnë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara tek studentët (https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program). <i>Referenca: Aneksi 65 (Lista e librave në funksion të programit të studimit)</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” përmban njohuri profesionale për aplikimin e teknikave të inxhinierisë së ndërtimit tradicionale por edhe të avancuara si për materialet e reja të ndërtimit ashtu dhe projektimin e strukturave të veçanta dhe atyre me shkallë të lartë vështirësie. Programi i studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi” korrespondon me Nivelin 7 të Kuadrit Shqiptar të AQF. Ai ofron njohuri të avancuara në inxhinierinë e ndërtimit. Në program janë përfshirë kurse që zhvillojnë aftësitë për zgjidhjen e problemeve inxhinierike e kërkimin shkencor në këtë fushë. Në syllabuset e lëndëve janë të reflektuara pjesa përmbledhëse dhe rezultatet e përfitimit të dijeve, përshkruhet dhe objektivi, synimet dhe kompetencat që studentët përfitojnë me mbarimin e studimeve duke siguruar përvetësim të njohurive, aftësive dhe kompetencave për këtë nivel studimi. Programi përfshin kurse për zgjidhjen e problemeve, kërkimin dhe inovacionin në këtë fushë <i>Referenca: Aneksi (https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program). Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit	Programi i studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë që kërkohen në këtë fushë.

mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë tek studentët një bazë shumë të mirë edhe për kërkimin shkencor, të nevojshme për ciklin e tretë të studimeve në doktoraturë dhe punësim e integrim të shpejtë me kërkesat që shtrun tregu i punës. GVJ, vlerëson, numurin e konsiderueshëm me mbi 60 marrëveshjeve bashkëpunimi dhe të mbi 110 kompanive bashkëpunuese për vende të lira pune dhe mundësi praktike. (Aneksi52- Politika e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit në funksion të programit). Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar organizon aktivitete të shumta si Forum i Hapur, Sesion Informativ, Vizita në Kompani dhe të tjera si Panairi i Karrierës (aktivitet vjetor) për mundësi punësimi për studentët nëpërmjet linkut (https://cpao.epoka.edu.al) ku studentët njoftohen për vende të lira pune. Në ditën e dytë të vizitës vlerësuese datë 05.03.2024, GVJ asistoi në eventin e “Panairi i Karrierës”, ku studentët dhe të diplomuar intervistoheshin për vendet e lira të punës nga kompanitë pjesëmarrëse. Përmbajtja e programit të studimit promovon punësimin e të diplomuarve në përputhje me tregun e punës. Zyra e karrierës gjatë vizitës na konfirmoi se 99% e studentëve të diplomuar në programin e studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” janë punësuar dhe shërbejnë në sektorin publik dhe privat. <i>Referenca: Aneksi 74 (Anketa e kënaqësisë së Kompanisë). Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik</i>		
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se lëndët/modulet janë të shpërndara në mënyrë të tillë që ato mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme, punësimin e studentëve si dhe rezultate të pritshme të kërkimit shkencorë. Ndarja e e veprimtarive formuese, raportet midis formimit teorik/praktik mundësojnë arritjen e objektivave, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin në përfundim të programit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi i studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” është hartuar nga stafi Akademik i Universitetit EPOKA. Për përshtatjen më të mirë me kërkesat e tregut të punës dhe identifikuar pikat e forta dhe të dobta të programit të studimit janë përdorur të dhëna cilësore dhe sasiore. Gjatë vizitë në institucion GVJ u njoh me të dhëna nga Zyra e Planifikimit të Karrirës e studentëve të Diplomuar (ZPKS) nën Zyrën e Dekanit të Studentëve kryen një Anketë të “Kënaqësisë së Kompanisë” në lidhje me kënaqësinë e studentëve gjatë punësimit të tyre dhe disa komente për përmirësimin e aftësive të të diplomuarve. Studentët janë pjesë e rëndësishme për përmirësimin e programit mësimor dhe si përfaqësues edhe në organet më të larta drejtuese të Institucionit si Senati dhe NJBSC, ata janë garant i përcjelljes së mendimeve dhe opinionëve nga studentë të diplomuar më parë, të cilët tashmë janë të punësuar në profesion në tregun e ndërtimit. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë mundur marrjen në konsideratë edhe të propozimeve nga bashkëpunorë e partnerë të interesuar në tregun e punës. <i>Referenca: Aneksi 19 (Për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik; Aneksi 74 (Anketa e kënaqësisë së Kompanisë).</i> https://universitetiepoka.al
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Universiteti EPOKA synon rritjen e përfshirjes së studentëve në nivelet vendimarrëse të institucionit si Senati akademik dhe NJBSC me të drejtë vendimarrje. Studentët marrin pjesë në organet vendimarrëse duke garantuar adresimin e të drejtave dhe shqetësimeve të tyre. Ata kontribuojnë edhe nëpërmjet mekanizmave të tërthortë, si Anketa e studentëve të diplomuar dhe Anketat e vlerësimit të Instruktorëve të Kurseve. Këto qasje nxisin një mjedis bashkëpunues në përmirësimin e planit mësimorë. Në konsultat e organizuara kanë marrë pjesë jo vetëm studentët që ndjekin studimet, por edhe ata që kanë kryer studimet; duke sugjeruar propozime për ndryshime të kurrikulave. Njësia bazë (dekanati) për vlerësimet e kryera merr dhe aprovimin e tyre në Senatin Akademik.

	<i>Referenca: https://universitetiepoka.edu.al; Shënime nga vizita në Institucion; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Referuar (RVB) si dhe takimeve të kryera në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin EPOKA me Dekanin dhe stafin akademik, vërejtje se njësia përmirëson, përditëson programin e studimit Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" me zhvillimet më të fundit në fushën e inxhinierisë së ndërtimeve. Bashkëpunimi me partnerë, rrjete dhe organizma të ndryshëm profesionistësh dhe institucione publike kanë pasuruar përvojën e stafit dhe kanë ndihmuar në përmirësimin e programit të studimit. Të gjitha aktivitetet bënë të ditura nëpërmjet faqes së internetit të departamentit https://ce.epoka.edu.al/neës-and-announcements.html .			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit përshtatet vazhdimisht me kërkesat e tregut të punës; njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin në konsideratë propozimet e institucioneve partnere, të studentëve të diplomuar dhe zhvillimit të teknikave të reja dhe të teknologjisë së ndërtimit në botë..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" ka si qëllim përgatitjen profesionale e shkencore të specialistëve të lartë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Universitetit EPOKA; si Statuti, Strategjia e Zhvillimit, Rregullore e Fakultetit dhe Departamentit etj., si dhe nga vizita dhe takimet në institucion, GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi", është në përputhje dhe në zbatim të planit strategjik dhe objektivave madhorë të strategjisë afatgjatë të zhvillimit të Universitetit EPOKA (Aneks 10, Plani Strategjik i Inxhinierisë së Ndërtimit); i fokusuar në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies,



	kërkimin shkencor, bashkëpunimin kombëtar e ndërkombëtar, studentët, etj.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Fakulteti Arkitekturës dhe Inxhinierisë bashkërendon administron veprimtaritë e mësimdhënies me ato kërkimore duke respektuar lirinë akademike. Gjatë takimit me stafin akademik, por edhe nga shqyrtimi i dosjeve të tyre, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, aplikon instrumenta nxitës të tillë si fondi i vënë në dispozicion nga IAL për kërkimin shkencor, mundësi për publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore në revistën shkencore, pjesëmarrje në konferenca shkencore. Autonomia dhe liria akademike janë të garantuara dhe ato bazohen në të drejtën ligjore dhe në Statutin e Universitetit EPOKA, neni 5; si dhe Rregulloren e Përgjithshme të tij. Personeli ka liri të plotë për të organizuar veprimtari mësimore, kërkimore dhe krijuese. Gjatë takimit me stafin akademik u vërejt se në nivel departamenti çdo vit hartohet plani vjetor i Kërkimit Shkencor, i cili parashikon edhe shpenzimet financiare të kërkuara. Komiteti Shkencor, I ngritur për këtë qëllim harton edhe programin shkencorë, i cili miratohet nga dekanati i FAI. Stafi i departamentit është përgjegjës për aktivitetet që kryhen, asiston në takime dhe ndjek procesin e studimit lidhur me strukturën, orarin e kurseve etj. <i>Referenca: Aneksi 7, Rregullore e Programit të Studimit të Ciklit të dytë, neni 7.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Universiteti EPOKA nxit dhe motivon studentët për pjesëmarrjen e tyre në kërkime shkencore, aplikimet për të cilat bëhen pranë Qendrës së Kërkimit shkencor. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit cakton një Këshillues mësimor në bazë të rregullores, që lidhet me programin e ciklit të dytë. Konsulenti, shërben edhe për studentët në përzgjedhjen e drejtimit të tyre të karrierës dhe menaxhimit të programit të Ciklit të Dytë të studimeve. Në fillim të çdo viti akademik, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit propozon aktivitete që synojnë përfshirjen e studentëve për pjesëmarrje në to. Studentët e Universitetit EPOKA janë të motivuar për pjesëmarrje në orët mësimore por edhe në thirrje e hapura për programet e shkëmbimit në universitete ndërkombëtare <i>Referenca: Aneks, neni 5(Lista e mobiliteteve e studentëve dhe e stafit akademik).</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë	Financimi i veprimtarive kërkimore e shkencore në Universitetin EPOKA realizohet nga kombinimi i burimeve të brendshme dhe të jashtme financiare, i cili menaxhohet nga një strukturë administrative e ngritur për këtë qëllim. <i>Së pari</i>, mbështetja kryesore financiare vjen

mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	nga vetë institucioni; <i>Së dyti</i>, nga të ardhurat e siguruar nga aktivitete të ndryshme, përfshirë bashkëpunimet me partner të jashtëm, donacione dhe financime nga projekte. Menaxhimi financiar dhe mbikqyrja e aktiviteteve kërkimore shkencore trajtohen nga Zyra e hulumtimeve dhe Projektëve nën drejtimin e Rektorit dhe në koordinim me Zyrën e Financave të Universitetit. Kjo zyrë është përgjegjëse për administrimin, koordinimin dhe ndjekjen e projekteve për kërkimin shkencor. Buxheti i universitetit për kërkimin shkencor propozohet nga Rektorati dhe miratohet nga Bordi Administrativ, i cili përfshin financimin e projekteve të fakultetit, pjesëmarrjen në konferenca dhe botimet në revista. Rektori është përgjegjës për të raportuar mbi mënyrën e perodimit të këtyre fondeve në Bordin Administrativ demonstroi për një strukturë të mirëorganizuar dhe të përgjegjshme për të nxitur një mjedis kërkimorë të pranuar nga të gjithë. <i>Referenca: Aneks 76 (Model operacional për Kërkimin Shkencorë); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik.</i>		
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson se programi i studimit ka të përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimeve shkencore. Njësia kryesore/bazë nxit veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike në këtë fushë. Programi, gjithashtu nxit studentët të angazhohen në shkëmbime e projekte kombëtare e ndërkombëtare dhe aktivitete kërkimore, duke u mbështetur edhe financiarisht nga institucioni.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të	Njësia përgjegjëse për këtë program studimi dhe personeli akademik nxitet të zhvillojë e zgjerojë kërkimin shkencorë në bashkëpunim me aktorë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe institucionet partnere. Realizimi i konferencave kombëtare është një shembull pozitiv i bashkëpunimit për çuarjen përpara të kërkimit shkencor në institucion dhe arrijten e objektivave të programit të studimit. GVJ vlerëson se programi i studimit

programit të studimit në kërkim shkencor.	mundëson, nxit dhe motivon stafin dhe studentët të angazhohen në botime shkencore. Është Komisioni për Nxitjen e Botimeve dhe Mbështetjen e Veprimtarive Shkencore që funksionon rregullisht për promovimin e botimeve shkencore. Nga ana tjetër, Zyra e Hulumtimeve dhe Projekteve promovon angazhimin e stafit akademik në kërkime shkencore; projektet e reja të brendshme të përzgjedhura për kërkimin shkencor, të cilat financohen nga institucioni. <i>Referenca: Aneks 76 (Udhëzues i Projekteve Kërkimore); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, mbështet dhe motivon stafin akademik për kërkimin shkencor dhe projektet. Praktika e deritanishme e stafit akademik tregon se pjesëmarrja e tyre në konferenca dhe publikimet e tyre është e mirë. Raporti vjetor i Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit tregon se Departamenti është i angazhuar edhe në organizimin e Konferencave Shkencore Ndërkombëtare; ashtu si edhe pjesëmarrjen në Konferenca Shkencore që organizohen me inisiativë të Institucioneve Partnere. Përveç stafit akademik angazhohen edhe studentë që kanë përfunduar studimet. Një nga evidencat e këtyre angazhimeve janë dhe mobilitetet dhe marrëveshjet e bashkpunimeve në kuadër të programeve ERASMUS. Artikujt, punimet dhe pjesëmarrjet akademike në fund të çdo viti akademik janë të renditura në Raportin Vjetor të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. <i>Referenca: Aneks 56 (Raporti vjetor i Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit, viti 2022-2023); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik.</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti si njësi bazë, organizon Konferenca Shkencore; dy Konferencat e fundit kanë qenë të organizuara në vitin 2020 “4-th International Balcans Conference on Challenges of Civil Engineering (BCCE 2020); (https://bccce.epoka.edu.al/2020). “The International Conference, Challenges in Eastern Balcans; Infrastructure and Development in the Region” (IFEES/GEDC/EPOKA) në vitin 2023 (https://egi.epoka.edu.al/2023). Në këto aktivitete stafi dhe studentët e diplomuar ndihen të angazhuar për të bashkëpunuar në prezantimin dhe publikimeve të studimeve të tyre shkencore në Revista Ndërkombëtare.

	<i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit në MP në “Inxhinieri Ndërtimi” është hartuar në përputhje me nevojat dhe kërkesat e ekonomisë së tregut, duke bërë të mundur punësimin e tyre jo vetëm në Shqipëri por edhe në vende të tjera të Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Gjuha Angleze është një nga pikat e forta, sepse edhe literatura e konsultuar në programet e lëndëve dhe përditësimi i tyre sipas kërkesave të tregut të punës i mundëson studentëve të këtij universiteti të jenë preferencialë në këto zgjedhje. Nga ana tjetër, harmonizimi i programit të studimit me programe studimi të tjera të ngjashme krijon përparësi për punësim të studentëve në tregjet e punës Brenda dhe jashtë vendit.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Programi i studimit në Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” është në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë”. Me kryerjen e studimeve studentët zotërojnë të gjitha dijet dhe kompetencat edhe për t’u pajisur me licensë profesionale nga ministria e linjës. <i>Referenca: Dokumentacioni bazë në procesin e akreditimit të programit të studimit MP në Inxhinieri Ndërtimi dhe Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik.</i>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	GVJ vlerëson se programi i studimit përmbush kërkesat e këtij kriteri pasi është në përputhje me aktet ligjore në vend referuar Nivelit të dytë sipas Kornizës Shqiptare të Kodifikimit dhe fushës 72MS, sipas fushës ku bën pjesë program KSNA-F2013 si dhe kuadrit Evropian të Kualifikimeve, Nivelit 7-të të tij duke evidentuar në çdo modul përmbledhjen, rezultatet e të nxënës, njohuritve që përfitohen, aftësitë dhe kompetencat.
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Njësia përgjegjëse për këtë program studimi nxit personelin akademik të zhvillojë e zgjerojë kërkimin shkencor në bashkëpunim me aktorë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe institucionet partnere. Departamenti është i angazhuar edhe në organizimin e Konferencave Shkencore</i>



	<i>Ndërkombëtare; (https://bccce.epoka.edu.al/2020), (https://egi.epoka.edu.al/2023). Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III.MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit në MP në “Inxhinieri Ndërtimi” bazohet në syllabuset e lëndëve, të cilat janë të organizuara në leksione, seminare, detyra/ projekte kursi, punë laboratorike dhe praktika mësimore, të cilat realizohen në përputhje me planin mësimorë (Aneks 5, Programi lëndor i kursit) dhe Aneks 49, Plani mësimor MP në Inxhinieri Ndërtimi). Syllabuset përcaktojnë formën dhe metodat e mësimdhënies, përmbajtjen e lëndës, ndarjen sipas orëve, etj. GVJ gjatë vizitës vlerësuese u njoh me metodat e mësimdhënies për këtë program studimi dhe elementët përbërës të tij, të parashikuara edhe në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit si: leksione direkte, leksione të hapura, seminare, ushtrime, laboratore, praktika mësimore e profesionale, vizita në kantjere, ekspozita, panairë, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike duke u mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, objektivat formues

	dhe kërkesat e punëdhënseve (https://ce.epoka.edu.al/neës-and-announcements.html dhe https://ce.epoka.edu.al/announcements.html). Laboratori i testeve të materialeve dhe provave të strukturave është i kompletuar me pajisjet dhe makineritë e nevojshme në shërbim të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit, ku studentët kryejnë punët laboratorike dhe praktikën profesionale. <i>Referenca: Aneks 5 (Programi lëndor i kursit; Aneks 49 (Plani mësimor MP në Inxhinieri Ndërtimi); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në programin e studimit janë të integruara forma të ndryshme të mësimdhënies e mësimnxënies si dhe kontrollit të dijeve të fituara; të cilat ishin në përputhje me përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve si dhe fushën apo natyrën e programit të studimit. Universiteti EPOKA në kuadër të Strategjisë Kornizë, 2018-2022 ka investuar për të siguruar një mjedis cilësor për mësimdhënien dhe mësimnxënien (<i>Aneks 9, Ofrimi i një mjedisi me cilësi të lartë për mësimdhënie dhe mësimnxënie</i>). Strategjia e përmirësimit të metodave në mësimdhënie e mësimnxënie dhe inkurajimi i fakultetit është objektiv kryesor në këtë Universitet, ku dallojnë: 1) <i>Trajnimit në fakultet për hartimin e përmbajtjeve të lëndëve në përputhje me Sistemin e Bolonjës</i> dhe 2) <i>Mobilizimi i stafit për të ngritur cilësinë në mësimdhënie dhe mësimnxënie</i>. Ajo që tërhoqi edhe vëmendjen e GVJ, është aplikimi në Universitetin EPOKA i metodave novatore të mësimdhënies HyFlex (<i>Aneks 77, Udhëzues për zhvillimin e mësimdhënies dhe aktiviteteve të tjera</i>). Gjatë mësimdhënies dhe zhvillimit të punëve laboratorike, stafi akademik mësimdhënës përdor metoda të grupimit të studentëve (ekipe) për të nxitur në to aftësitë e të nxëniet në bashkëpunim; në projekte, studime, prezantime në grup dhe shkëmbim të mendimeve e ideve edhe me pjesën tjetër të studentëve të klasës. Nderthurja e teorisë me praktikën në pothuaj të gjitha lëndët/modulet e formimit bazë dhe specifik, perfshirja e studentëve dhe marrja e mendimeve të tyre ka mundësuar realizimin me sukses të të gjitha veprimtarive të programuara. (https://epoka.edu.al/mat/legal-acts/Statute_Uni_EPOKA_en.pdf) Studentëve iu janë krijuar kushte dhe mundësi për të shfrytëzuar aftësitë e tyre kompjuterike, për të patur akses edhe në dokumente të tjera në shkollë ashtu edhe kur janë jashtë saj.

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Universiteti EPOKA mbështet personelin akademik për përmirësimin e kompetencave të tij nëpërmjet trajnimeve vjetore. Kështu, në kuadër të projekteve Erasmus+ janë organizuar trajnime për “Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë” në Nëntor 2023, apo Trajnimi “Të nxënit Virtual Bashkëpunues në praktikë”, në Tetor 2022 si dhe Trajnimi “Zhvillimi i planit mësimor nëpërmjet rezultateve të të nxënit dhe sigurimi i cilësisë përmes rishikimit të planit mësimor” nga ekspertë të Shërbimit Gjerman të Shkëmbimit Akademik (DAAD), Shtator 2023, (Aneks 15, Lista e Aktiviteteve Trajnuese në nivel institucioni dhe departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit). Gjithashtu, stafi akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike përfiton edhe në kuadër të shkëmbimeve të programit ERASMUS+. <i>Referenca: Aneks 15 (Lista e Aktiviteteve Trajnuese); Aneks 48 (Raporti Vjetor DoS 2021-2022).</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie përzgjidhet nëpërmjet një procesi serioz, për vlerësimin e njohurive dhe metodave të mësimdhënies. Dokumentet personale të stafit akademik si “Formulari i Aplikimit të stafit akademik” (Aneks 78), vlerësimi i përvojës dhe kompetencës nëpërmjet një leksioni të hapur janë pjesë të rëndësishme në këtë vlerësim (Aneks 79, Formulari i vlerësimit të leksioneve të Hapura”). Një metodë tjetër, që vlerëson kompetencën është ndarja e lëndëve të këtij programi studimi, sipas fushës së kualifikimit të stafit, verifikim që departamenti e kryen nëpërmjet CV të stafit akademik të anagazhuar në programin e studimit Inxhinieri Ndërtimi (Aneks 6) dhe Planit mësimor që lidhet me stafin akademik (Aneks 80, tabela e përgjithshme). Lëndët në këtë program studimi, përfshijnë edhe metoda interaktive në mësimdhënie dhe mësimnxënie, përfshirë edhe studentët në diskutime gjatë orëve të mësimi. Universiteti EPOKA, për mbikqyerjen e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve Master, ka adoptuar një metodë nëpërmjet këshilluesit akademik. Ata janë pedagogë dhe bëjnë pjesë në programin e studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi”, caktohen për çdo klasë dhe për çdo vit akademik. <i>Referenca: Aneks 6 (Curriculum Vitae e personelit akademik); Aneks 78 (Formulari i aplikimit për personelin akademik), Aneks 79 (Formulari i vlerësimit të leksioneve); Aneks 80 (Tabela përmbledhëse).</i>

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit është njësia bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit dhe sigurimin e cilësisë. Aftësitë mësimdhënëse të stafit akademik vlerësohen rregullisht sepse në bazë të tyre kryhet edhe vlerësimi i të nxënit dhe cilësisë së mësimdhënies. Si formë matëse shërben “Anketa e Vlerësimit të pedagogut të lëndës” (Aneks 22), që plotsohet nga studentët në fund të çdo semestri; në këtë vlerësim studentët janë të lirë të japin edhe mendime e sugjerime për ecurinë e lëndës. Anketa përbëhet nga 14 pyetje, ndërmjet të cilave përmendim: përpikmërinë e pedagogut, përgatitj të lëndës, materialet e lëndës, metodologjia e mësimdhënies, ndërveprimi me studentët, vlerësimi i performancës së studentit, etj. Ngarkesa mësimore për personelin akademik dhe studentët është shpërndarë në mënyrë të tillë që mundëson një ngarkesën normale të studentëve në përputhje me normat sipas kuadrit ligjor në fuqi. <i>Referenca: Aneks 48 (Raporti Vjetor DoS 2021-2022).</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Struktura që punon për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi është Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe sektorët në varësi të tij si Zyra e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, Bordi i Provimit dhe Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Bordi i Cilësisë; të gjitha këto në zbatim të “Politika e Universitetit EPOKA (Aneks 19), për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit” dhe “Manuali i Sigurimit të Cilësisë i Universitetit EPOKA (Aneksi 32). Në lidhje me zhvillimin e metodave të reja inovative mësimore, Universiteti EPOKA ofron trajnime vjetore për stafin eksistues dhe atë të ri. Për këtë qëllim, njësitë paraqesin në Rektorat planet e aktiviteteve të tyre me propozime konkrete para fillimit të vitit të ri akademik. (Aneks 39). Këto aktivitete përmbajnë nevojat për staf të ri akademik sipas nevojave të studentëve në lidhje me mësimdhënien dhe aktivitetet e të nxënit sipas përparësive në përputhje me Strategjinë dhe Planin e Veprimit (Aneks 9). Disa nga programet e trajnimeve (Lista e plotë e Trajnimeve, sipas Aneks 81), janë sa vijon: - 25 e 26 Shtator 2019 Zyra e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme ka organizuar trajnimin me stafin akademik për “Edukimi dixhital”; - 16 Tetor 2020, ZSCB në bashkëpunim me Zyrën Kërkimeve dhe Projekteve, Qendrën e Edukimit të vazhdueshëm dhe ZKTIK, kanë

	organizuar trajnimin për stafin akademik të emeruar “Mësim Online/HyFlex”; - Universiteti EPOKA si pjesë e “Shkëmbimeve virtuale të universiteteve Shqiptare -Europiane”, ka marrë pjesë në Forumin e Experteveve “Mësimdhënia dhe të Nxënës Virtualë Inovative”: https://ëëë.epoka.edu.al/neës-epoka-university-co-hosted-a-series-of-expert-forums-on-innovative-virtual-teaching-and-learning-5296.html https://ëëë.eëpoka.edu.al/neës-epoka-staff-participates-in-training-session-on-microsoft-teams-pltaform-5298.html - “Sesion Trajnimi mbi Platformën Microsoft Teams”, 23 Janar 2021, stafi akademik ka marrë pjesë në Konferencën e 5-të Vjetore Ndërkombëtare “Edukimi Sof” etj. <i>Referenca: Aneks 9 (Strategjia e Universitetit EPOKA); Aneks 32(Manual I Sigurimit të Cilësisë); Aneks 39(Ekipi i aksesueshmërisë) Aneks 81 (Tabelat përmbledhëse); Aneks 48 (Raporti Vjetor DoS 2021-2022).</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se format në mësimdhënie, mësimnxënie dhe transmetimi i dijeve dhe njohurive realizohen nëpërmjet leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave/projekteve të kursit, etj. Metodot e mësimdhënies realizohen në forma të ndryshme si interactive dhe diskutime, ato nxisin mendimin krijues, kritik dhe autonominësi dhe aplikim të metodave të reja në mësimdhënie.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore	Referuar dokumentacionit të aksesuar si dhe takimeve të zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive, përcaktohen si në Rregulloren për programet e studimit të Ciklit të dytë të studimeve në nenin 37 të saj, kriteret e vlerësimit

përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullor e të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	(https://epoka.edu.al/mat/regulations/-on-second-cycle-study-programs.pdf). Pas rregjistrimit të tyre sekretaria i pajis studentët me “Guida e Studentit e Universitetit EPOKA”, (https://epoka.edu.al/mat/student_guide/Smart%20Student%20Guide.pdf) që informon studentët me proceset e mekanizmat e studimeve të tyre. Kriteret dhe mënyra e testimit apo vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive janë publike dhe përmenden në Guidën e Studentit dhe rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë “Nota përfundimtare e një lënde përfshin vlerësimin e të gjitha komponentëve të lëndës brenda një semestri dhe rezultatit të provimit përfundimtar sipas sistemit të vlerësimit të performancës së lëndës “Guida e Studentit (<i>Aneks 61</i>). Të gjitha këto elemente, gjithashtu i bëhen të ditura studentëve dhe janë të publikuara në EEB-site të Universitetit EPOKA: https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program. <i>Referenca: Aneks 61 (Guida e studentit EPOKA);</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo lënde studentët njihen me metodat e testimit dhe vlerësimin e tyre. Detaje dhe informacione për programin e studimit në Inxhinieri Ndërtimi gjenden në forma të ndryshme; të shkruara dhe elektronike. Programet e lëndëve janë të publikuara në faqen kryesore të Universitetit EPOKA siç janë: - https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program - https://eis.epoka.edu.al/curricula/syllabus/15908/1/37 - https://eis.epoka.edu.al/curricula/syllabus/15910/1/37 Prezantimi i programit të lëndës bëhet nga çdo pedagog në orën e parë të mësimit. Është përgjegjësi e stafit akademik t’i njohë studentët gjatë javës së parë të semestrit me programin e plotë të të lëndës; ku studentët njihen edhe me objektivat e lëndës, tematikat, literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar, metodat e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. Nga ana e tyre studentët mund të njihen për këto informacione dhe në faqen e internetit në systemin interaktiv EPOKA (IES); (<i>Aneksi 80, Tabela 15, modeli i programit lëndor</i>) dhe programet lëndore (<i>Aneks 5, programet lëndore</i>).

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i studentëve është i shprehur në programet lëndore për çdo lëndë. Metodatat që përdoren për kontrollin e njohurive dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në rregulloren mbi vlerësimin e studentëve duke u dhënë mundësi studentëve të tregojnë kompetencat dhe njohuritë e fituara, bëhet nëpërmjet një kombimi të kriterëve që vijnë: -Detyra shtëpie, Prezantime, Projekte, Kuize, Laboratore, prova laboratorike/praktike, Punë seminari, pjesëmarrja aktive dhe frekuentimi etj. Provimi i ndërmjetëm (<i>Midterm Exam, java e 8 e semestrit</i>); Provimi përfundimtar (<i>Final Exam, javët 15 e 16</i>); Riprovime (<i>Ri-examination</i>) dhe Mbrojtja e tezës për diplomim (<i>Diploma thesis defence</i>). Si rregull, provimi mund të përbëhet nga 3-5 kategori pyetjesh të cilat mund të ndryshojnë në varësi të lëndëve dhe moduleve: - Pyetje që kontrollojnë njohuritë, - Pyetje për të testuar afësitë analitike, - Pyetje që kërkojnë mendim dhe pohim individual të studentit (në formën e analizave kritike, raste studimore, ose ushtrime). Nota përfundimtare përfshin vlerësimin e të gjitha komponentëve të përmendur më lart duke marrë në konsideratë dhe Pjesëmarrjen; Detyrat e kursit; Testime (të ndërmjetme, projekte etj) dhe Provimi përfundimtar. Në respektim të lirisë akademike, mes këtyre kategorive ka një marzh shmajeje prej 10-20%. <i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se metodatat e vlerësimit të njohurive dhe dijeve e kompetencave janë përcaktuar të plota në rregulloren e programit të studimit, ato janë publike dhe njihen nga studentët. Këto u bëhen të njohura studentëve në fillim të çdo viti të ri akademik për çdo lëndë/modul.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	GJV referuar burimeve alternative, syllabuseve, rregulloreve e stafit akademik konkludon se elementet kryesore të kontrollit të vazhdueshëm gjatë semestrit janë: provimet, punimet/projektet dhe

profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	niveli i aktivizimit në seminare apo punë laboratorike, provime të ndërmjetme, vlerësime në bazë të pyetje/përgjigjeve, etj. Periudhat e provimeve për këtë program studimi janë: - Provimi i ndërmjetmë, java e 8 semstrit, - Provimi final, javët 15 dhe 16 të semstrit. Midis këtyre periudhave studentëve u kërkohet të punojnë në studime, hartimin e projekteve, të bëjnë prezantime etj. GVJ mendon se fusha e vlerësimit të studentëve është e gjerë dhe e shpërndarë gjatë gjithë periudhës së semestrit. <i>Referenca: Aneks 5(Kurrikula e Programit të Studimit MP, Inxhinieri Ndërtimi); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Universiteti EPOKA përdor sistemin elektronik interaktiv (EIS), nëprmet të cilit studentët menxhanojnë shumë procedura që lidhen me lëndët dhe universitetin; kështu ata mund shikojnë informacione mbi lëndët, notat, frekuentimin e lëndës, dhe të mund të bëjnë edhe zgjedhje të lëndëve për çdo semestër. (Aneksi 71, Udhëzuesi i studentit për Sistemin Interaktiv EPOKA). Në këtë mënyrë sistemet e testimit dhe vlerësimit të studentëve janë transparente, me fokus eliminimin e formave të ndryshme të abuzimit. Provimet zhvillohen në anonimitet të plotë (Aneksi 25, Vendimi i Rektioratit 2019/037 datë 05.11.2019 për sigurimin e anonimitetit të Provimeve). Për të siguruar anonimatetin e provimeve institucioni ka një ngritur një strukturë ku çdo student në sistemin EIS pajiset me një kod unik në periudhën e provimeve, për të cilin ka dijeni vetëm studenti dhe koordinatori i departamentit (Aneksi 26, procesi i Anonimatetit të provimeve). Sallat ku zhvillohen provimet mbikqyren me sistem kamera, në provim asistojnë edhe pedagogë ose asistentë pedagogë si mbikqyrës (Aneksi 23, Udhëzuesi mbi Provimet). <i>Referenca, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Referuar takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion si dhe Rregullores së Programit të Studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi”, “Mbi Programet e Studimit të Ciklit të dytë”, neni 37, GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje të plotë me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Studentët informohen paraprakisht për kriteret e dhe procedurat e vlerësimit. Nga ana e tij, Bordi i Provimeve (https://qeqi.epoka.edu.al/cat-exami-board-2607.htm), vepron si verifikues i cilësisë për provimet.

	Ky komision harton raporte për çdo semestër për të gjitha lëndët e të gjitha programeve të studimit dhe bën sugjerime e rekomandime për përmirësime (<i>Aneksi 82, Udhëzuesi mbi Funksionimin e Bordit të Provimeve</i>). <i>Referenca, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Referuar dokumentacionit të aksesuar si dhe takimeve të zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Në bazë të “Udhëzues mbi Funksionimin e Bordit të Provimeve” (<i>Aneksi 82</i>) dhe Udhëzues i Universitetit EPOKA “Mbi provimet” (<i>Aneksi 23</i>), zyra e Dekanit ka emëruar një ekspert për Programin e Studimit Master profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” për të vlerësuar cilësinë e provimeve; si garant kryesor për sigurinë e vlerësimit të kompetencave dhe aftësive të studentëve në provime. <i>Referenca, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	GVJ. pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në RVB periodik si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se Universiteti ndjek politika lidhur për kopjimin, plagjiaturën dhe çdo element tjetër që shtrembëron vlerësimin e studentit duke u bazuar në Rregulloren Institucionale (<i>Aneksi 24</i>) “Për disiplinën e studentëve”; përkatësisht neni 5 (d), neni 6 (d) dhe neni 8(m) sipas (<i>Aneksi 2</i>); për të cilat studenti informohet për këto rregulla edhe nëpërmjet "Guida e studentit. Gjithashtu Universiteti aplikon programin Turnitin, për të verifikuar plagjiaturën për detyrat e shkruara, detyrat javore, dhe teza e diplomave (<i>Aneksi 72, Infrastruktura e IT në funksion të programit të studimit</i>). Gjithashtu, në Universitetin EPOKA është themeluar dhe Bordi i Provimeve, i cili monitoron procesin e zhvillimit të provimeve. Për të siguruar transparencën aplikon dhe vlerësimin anonym, ku në fletët e provimeve në vend të emrit të studentit vendoset kodi unik i tyre. <i>Referenca, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe	Të gjitha provimet zhvillohen në anonim të plotë, sepse në fletën e provimit shënohet vetëm kodi unik i studentit (<i>Aneks 26, Procesi i anonimitetit të Provimeve</i>). Kodi njihet vetëm nga studenti dhe koordinatori i Departamentit. Kodet janë sipas sistemit EIS,

jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	vlerësimi nga pedagogu bëhet sipas kodit unik të studentit dhe jo emrit të tij. Pedagogu i sheh emrat e studentëve vetëm pas finalizimit të vlerësimit dhe vendosjes së notave që ai ka vendosur. Afatet e perfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qarte dhe të shpallura. Ato monitorohen dhe ndiqen nga afër nga institucioni gjatë gjithë procesit mësimor në përputhje me rregulloren e universitetit dhe specifikimeve të syllabuseve. Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritën e studentëve dhe i bëhen të ditura në mënyrë individuale studentëve me paraqitjen fizike të tyre ashtu edhe online. <i>Referenca, Rregullore e Programit të Studimit, Rregullore dhe Statuti i Universitetit EPOKA, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB). Shënime gjatë Vizitës vlerësuese në institucion.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Universiteti Epoka garanton të drejtën e studentëve për informim për vlerësimin njëherazi edhe për të kërkuar rishikim të vlerësimit. Sipas Neni 29, i Rregullores “Për Programet e Studimit të Ciklit të Dytë” (Aneks 27), brenda pesë ditëve pas publikimit të rezultateve të provimit, studenti ka të drejtën të bëjë ankesë për ankimim të notës në sekretarinë e Mësimore, duke kërkuar rishikim të provimit (Aneks 30) “Formulari i kërkesës për Ankimimin e Notës”. Pedagogu i lëndës rishikon çelësin e përgjigjeve për ndonjë gabim të mundshëm të bërë në vlerëimin e studentit; procesi i rishikimit të notës përfundohet nga zyra e Dekanit pasi departamenti ka bërë propozimin. Studenti njoftohet për vendimin e marrë jo më vonë se 15 ditë nga dita që ka dorëzuar kërkesën, (Aneks 7- Rregullore e Programit të ciklit të dytë të studimeve). https://epoka.edu.al/mat/regulations/regulation-on-second-cycle-study-programs.pdf <i>Referenca, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Për çdo kërkesë ose ankimim që shfaq studentit për vlerësimin e tij në provime të ndërmjetme ose përfundimtare, detyra kursi/projekte, etj. ngrihet komisioni i vlerësimit, i cili harton një raport, të cilin bashkë me kërkesën dhe rezultatin e rivlerësimit të studentit e dorëzon në dekanat për të marrë një vendim final. Është sekretaria mësimore, ajo që njofton studentin nëse ka patur ose jo ndryshim nga vlerësimi i mëparshëm i studentit (Aneks 61)

	https://epoka.edu.al/mat/regulations/regulation-on-second-cycle-study-programs.pdf dhe (Aneks 7) Rregullore "Për Programet e Studimit të Ciklit të Dytë" https://epoka.edu.al/mat/regulations/regulation-on-second-cycle-study-programs.pdf Sekretaria mësimore ngarkohet për të ndjekur dokumentacionin Referenca: (Aneks 7, rregullore e "programit të Studimit, Cikli dytë"); (Aneks 61, Neni 63 Guida e studentit); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik, që në fund pasqyrohet me vlerësimin final. Në provime ruhet anonimati i studentëve nëpërmjet kodit unik elektronik (EIS) dhe programit Turnutin, duke shmangur kopjimin dhe plagjaturën në të gjitha punimet e shkruara. Rishikimi i vlerësimit të provimeve është një e drejtë e studentëve që vlerësohet nga Komisioni i vlerësimeve sa herë studenti aplikon për rishikim të vlerësimit. Të gjitha dokumentacionet arkivohen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në ASCAL si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se kurrikula e (https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program) programit të studimit (Aneks 49, Kurrikula e programit të studimit "Master Professional" në Inxhinieri Ndërtimi dhe Aneks 5, Programet Lëndore), përmban module dhe lëndë sipas udhëzimit 41, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të menaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit. Në program përfshihen lëndë të tilla si: Strukturat e betonit të armuar, (https://eis.epoka.edu.al/curricula/syllabus/15910/1/37/) dhe

	Building Construction Estimating, Advanced, Project Planning, Constructing Materials, Term Project, etj. lëndë me zgjedhje. Këto lëndë, së bashku me të tjerat në programin e studimit zhvillojnë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve që ndjekin këtë program studimi, duke qenë se këto njohuri i përkasin studimeve të ciklit të dytë. <i>Referenca: (Aneks 49, Kurrikula e "Programit të Studimit"); (Aneks 5, Programet lëndore); Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në zbatim të VKM 41, datë 24.1.2018, GVJ konstatoi se modulet janë të ndara në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. Programi oftohet në gjuhën angleze dhe u mundëson studentëve për të rritur nivelin e aftësive të tyre në fushën e teknologjisë së informacionit, në atë të komunikimit; çdo lëndë ka një nivel të caktuar për të arritur objektivat e programit të studimit (Aneks 49), (https://eis.epoka.edu.al/curricula/74/program). Aftësimi në fushën e teknologjisë së informacionit realizohet nëpërmjet CE 562 Aplikimet Kompjuterike në Inxhinieri Ndërtimi (Kategoria C) dhe CE 470 Praktika Profesionale (Kategoria D). Në këto lëndë ndërthuret mjaft mirë leximi, shkrimi dhe komunikimi me aftësitë kërkimore dhe aplikimin e mjeteve IT. <i>Referenca: Aneks 49, Kurrikula e programit të studimit); (Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Referuar Kurrikulës së programit të studimit Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimi si dhe takimeve të zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ vëren se studenti në këtë program studimi nëpërmjet lëndëve, objektivave të tyre, fiton aftësitë, njohuritë dhe kompetencat për të kryer e zbatuar detyra specifike. Në nivel institucional, kjo rregullohet nëpërmjet Udhëzimit të Universitetit EPOKA "Për funksionimin e Bordit të Provimeve" (Aneks 82), duke veçuar dy momente që janë: a ja ka arritur provimi të plotësojë objektivat e kursit dhe niveli i leksioneve gjatë zhvillimit të mësimave. Ndërsa në nivel individual, në javën e fundit pedagogët zhvillojnë përsëritje të lëndës (java e fundit) ku shkëmbëhen mendime për njohuritë e fituara.

	<i>Referenca: Aneks 82, Programet lëndore për lëndët"); (Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ vëren se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që i pajisin studentët me aftësi për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit dhe plani mësimor, u japin mundësi studentëve për të zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë. Infrastruktura; klasat auditotët, laboratorët janë në shërbim të programit të studimit (Aneks 67, <i>Infrastrukturura në Funksion të programit të Studimit dhe (Aneks 68, Udhëzim për Bibliotekën</i>). Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyrat e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojnë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut. Siç është evidentuar edhe më sipër si institucioni ashtu edhe personeli akademik kanë krijuar klimën dhe infrastrukturën e nevojshme të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të avancuara kërkimore e shkencore dhe ka mbështetur aktivitete të tilla si organizimi i Konferencave Studentore apo zhvillimin e disa ideve inovative e teknologjike në dobi të institucionit, shoqërisë ose palëve të treta. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se institucioni ka nënshkruar marrëveshje shkëmbimi bilaterale me universitete partnere (Aneks 52, <i>Lista e universiteteve partnere</i>) në Evropë si Universiteti i Barit, Itali; Universiteti i Vigos, Spanjë; Universiteti i Iashit, Rumani etj. ku studentët dhe stafi kryejnë shkëmbime mobiliteti (Aneks 22, <i>Lista e shkëmbimeve të studentëve dhe stafit të programit të studimit MP në Inxhinieri Ndërtimi</i>). <i>Referenca: (Aneks 22, Lista e shkëmbimeve të studentëve dhe stafit të programit të studimit MP në Inxhinieri Ndërtimi); (Aneks 52, Lista e universiteteve partnere) Aneks 67, Infrastrukturura në Funksion të programit të Studimit; (Aneks 68, Udhëzim për</i>

	<i>Bibliotekën"); (Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>		
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i departamentit jashtë programit mësimor është i përfshirë në aktivitete e veprimtari shkencore, për të qëndruar sa më afër bashkëpunimit me industrinë e ndërtimit në kuadër të këtij programi studimi. Marrëveshjet dypalëshe përmbajnë organizimin e përbashkët të leksioneve dhe seminareve të hapura (<i>Aneks 52, Marrëveshjet e Partneritetit</i>), https://ce.epoka.edu.al/neës-and-announcements.html). <i>Rederenca: (Aneks 52, Marrëveshjet e Partneritetit); (Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>		
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Studentët e programit të studimit në Inxhinieri Ndërtimi, jashtë procesit mësimor përfshihen edhe në aktivitete jashtëkurrikulare. Zyra e Dekanit të Studentëve (DS) ju ofron mundësi që studentët të përfshihen në klube studentore për të promovuar dhe zhvilluar aftësitë e idetë e tyre inovative. Ata mund të marrin inisiativën për të hapur një klub të ri ose të bashkohen me ato ekzistues. Universiteti Epoka financoi rreth 20 klube të tilla (https://clubs.epoka.edu.al) Klubi i Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit nën emërtimin "Klubi i Inxhinierëve të ardhshëm" (FEC), i cili kryen shumë aktivitete që lidhen me fushën e studimit të tyre: https://sites.google.com/epoka.edu.al/future-engineers/. <i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>		
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriteve të këtij standardi, GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" ofron aftësitë e nevojshme në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, komunikimit ndërveprimit në gjuhën angleze. Universiteti Epoka nxit idetë novative në kërkime shkencore dhe jep mbështetje financiare.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në ASCAL si dhe gjatë vizitës në Institucion konstaton se Universiteti EPOKA u ofron studentëve vetëm mundësinë e diplomimit me Tezë Diplome dhe jo me Provim Final. Për mbrojtjen e diplomës institucioni ka hartuar kriteret specifike për detyrimet përmbyllëse në programet e Ciklit të Dytë të Studimeve (https://epoka.edu.al/mat/regulations/regulation-on-second-cycle-study-programs.pdf) lidhur me kërkesat për diplomim. Studentët kanë mundësi që nëpërmjet statusit dhe llogarive personale të tyre mund të gjejnë akses në sistemin interaktiv EPOKA (https://eis.epoka.edu.al) i cili, i ndihmon studentët për kriteret e hartimit të tezës së diplomës. <i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit dhe në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në Universitetin EPOKA, program i studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” nuk përfshin provim të përgjithshëm përfundimtar. Studentët vlerësohen nga lëndët e caktuara në kurrikulën e programit dhe hartimin e tezës së diplomës. (CE 420-Projekti Final) i aksesueshëm në linkun: (https://eis.epoka.edu.al/curricula/syllabus/12225/1/37).
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e	Gjatë semestrit të dytë të studimeve, studentët përzgjedhin si lëndë kryesore “Projekti final” që ka të bëjë me punimin e temës së diplomës. Për udhëheqjen e temës së diplomës, për çdo student caktohet një pedagog, i cili njëkohësisht krijon kushte e mundësi që studentit të punojë në mënyrë të pavarur. Pedagogu udhëheqës konsulton studentin në etapat e realizimit të diplomës deri në variantin final. (Aneks 5, Programet lëndore që përmban kurrikula e programit të studimit Master professional në Inxhinieri Ndërtimi). Në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës hartojnë programin e temës së diplomës, ku janë të përfshira dhe konsultimet. Udhëheqësi

punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	i temës së diplomës garanton cilësinë e rezultateve të arritura; do të asistojë dhe udhëzojë studentin gjatë gjithë periudhës deri në miratimin ose jo në dorëzimin e variantit final. <i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Periodik (RVB).</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët e Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit në plotësim të objektivave të programit të studimit, kanë në dispozicion të tyre për kryerjen e testeve të materialeve të ndërtimit dhe provave të strukturave laboratorin e Universitetit Epoka (<i>Aneks 67, Infrastruktura në Funksion të Programit të Studimit</i>) dhe (<i>Aneks, Udhëzim "Mbi bibliotekën"</i>). Gjithashtu, fondi i burimeve të revistave shkencore JSTOR, në ndihmë të stafit akademik dhe studentëve; programet dhe softwerët për kryerjen e testeve dhe regjistrimet e të dhënave të fituara gjatë provave, sigurohen nga institucioni, nëpërmjet zyrës së TI të Universitetit Epoka.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas Aneksit 7, Rregullore "Për provimet e Studimeve të Ciklit të Dytë", Neni 37, Mbrojtja e punimit të Diplomës vlerësohet me notë. https://epoka.edu.al/mat/regulations/regulation-on-second-cycle-study-programs.pdf
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Referuar dokumentacionit të aksesuar si dhe takimeve të zhvilluara në institucion GVJ konstatoi se programi Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" ka të miratuara procedurat për diplomim (<i>Aneks 25</i>) dhe pajisjen me suplementin e diplomës (<i>Aneks 29</i>) të rregjistruara në EIS, në përputhje edhe me Urdhërin nr. 78 datë 13.05.2020, Prot.1434/6 të MAS/QSHA. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me to. Gjithashtu, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Universiteti Epoka ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit për çdo student dhe rast pas rasti paraqet, informacione për studentin, për gjithë periudhën e studimeve nëqoftëse do të kërkohen. Afatet e ruajtjes së dokumentave përshkruhen dhe ndiqen sipas "Rregullore Institucionale", Rregullore e Arkivit.

Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se Personeli akademik/ udhëheqësi i diplomës orienton studentët në përmbushjen e programit të diplomës me nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, shkrimin përfundimtar sipa udhëzimeve përkatëse. Në fund të punimit dhe mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset zyrtarisht me diplomën dhe suplementin e saj, formatet e të cilave janë të miratuara nga Ministria e Arsimit Rinisë e Sporteve. I gjithë dokumentacioni i studentit (kopje) arshivohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast se dokumentacioni kërkohet nga studenti për arsye të caktuara, i jepet atij pa asnjë pengesë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Programi i studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi”, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive ka siguruar mjedise të përshtatshme brenda Universitetit Epoka për realizimin e praktikës laboratorike. Kështu, Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit është një mjedis i kompletuar me pajisje dhe makineri të testimit të materialeve dhe provave të strukturave të ndërtimit. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit në bashkëpunim me Zyrën e Planifikimit të Karrierës siguron zhvillimin e praktikave mësimore pranë institucioneve partnere (Aneks 80, Pasqyra përmbledhëse) mbi marrëveshjet për praktikën profesionale të Masterit Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi”.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit në bashkëpunim me partnerët me të cilët ka marrëveshje (Aneks 80, Pasqyra përmbledhëse), garanton zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve në përputhje me planin mësimor të programit të studimit. https://ce.epoka.edu.al/home-agreements-187-2286.html

përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.					
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika mësimore e ekuivalentuar me 7.5 kredite bën pjesë në Klasifikimin e Kategorisë D të veprimtarisë formuese akademike dhe si lëndë e detyrueshme vlerësohet me notë. Studenti gjatë kryerjes së praktikës mësimore fiton njohuri dhe konkretizon problematikat të ndryshme të zhvilluara në lëndët teorike. (https://epoka.edu.al/mat/guidelines/Guideline on the Conduct of the Professional Practice_atPM.pdf)				
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se institucioni është garant për realizimin e praktikave laboratorike dhe atyre profesionale në funksion të mësimdhënies.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table> <tr> <th>Përmbushet kryesisht</th><th>Përmbushet plotësisht</th></tr> <tr> <td></td><td>X</td></tr> </table>	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X
Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
	X				

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli	Në shqyrtim të dokumentacionit të DVV, takimit me personelin akademik si dhe takimit me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore GVJ konstatoi që personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli

ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

ndihmës akademik, i angazhuar në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Ai ka nivelin e duhur të kualifikimit për drejtimin e PS Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi”. Personeli akademik i angazhuar me këtë PS mbulonte të gjitha lëndët/modulet mësimore të programit. I gjithë aktiviteti i tij shkencor lidhej me fushën kërkimore të programit të studimit. Konkretisht, për PS Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi”, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit kishte angazhuar, sipas viteve, personelin akademik si më poshtë:

Tituj/grada	2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	1	-
Prof.As.Dr	2	-	1	-
Dr/PhD	3	-	3	-
Msc	-	-	-	-
Në total	5	0	5	0

Siç del edhe nga këto të dhëna plotësohet kriteri që përcakton ligji 80/2015 që çdo departament duhet të ketë së paku 3 antarë me kohë të plotë me gradën doktor.

Referenca:

-RVB

-Shënime nga vizita në Institucion

-Shtojca 12 “Rregullore e rekrutimit të stafit”

- <https://ëëë.epoka.edu.al/>

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Programi i studimit Master Profesional në “Inxhinieri Ndërtimi” zhvillohet në 1 vit shkollor (1 semestër). Plani mësimor përmban gjithsej 5 lëndë+ praktika profesionale + projrkti i diplomës. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Ngarkesa e përgjithshme në auditor që duhet të përballojë personeli akademik efektiv në këtë diplomë është:

Leksione 192
Seminare 224

	Ushtrime/Laboratorë 0 Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor 112 Praktikë profesionale 128 Diploma/Provim Formimi 8 Në total 852 Referuar numrit të përgjithshëm të PAE (4) për këtë program studimi dhe ngarkesës prej gjithsejt 852 orë, GVJ gjykon që ngarkesa mësimore mbulohet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (UDHËZIM NR. 29, DATË 10.09.2018 PËR VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË) <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse -Shtojca 83 "Direktiva për ngarkesën mësimore" - https://www.epoka.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Referuar numrit të stafit të angazhuar për këtë PS gjatë viteve 2020-2023 konstatohet që për vitin 2020-2021 kanë qenë 5+0 (PAE+PAK), për vitin 2021-2022 kanë qenë 5+0 (PAE+PAK) dhe për vitin 2022-2023 5+0 (PAE+PAK). Duke konsideruar numrin e vogël të studentëve (1-2) në këtë diplomë GVJ konfirmon qëndrueshmëri të personelit. Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerzore GVJ konsultoi dosjet e personelit dhe gjeti që ato ishin të plota konform kërkesave ligjore. Shënojmë që për vitet akademike 2019-2020 dhe 2023-2024 programi nuk është hapur për mungesë studentësh. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - https://ëëë.epoka.edu.al/
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe	Në materialet e DVV, vizitën në zyrën e burimeve njerzore, takimin me personelin akademik dhe konsultimin e faqes zyrtare në internet të Universitetit Epoka https://www.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html, GVJ konstaton që në këtë IAL ndiqen të gjitha procedurat ligjore të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit, të cilat garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në

specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Shtojca 12 "Rregullorja për rekrutim stafi" - https://ëëë.epoka.edu.al/
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Referuar CV-ve të personelit ndihmës akademik të angazhuar në PS Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi", ngarkesës në syllabuset e lëndëve përkatësisht moduleve, aktiviteteve mësimore dhe vizitave në auditoret dhe laboratorin ku zhvillohet procesi mësimor, GVJ konstaton që universiteti Epoka siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Sa i përket diplomës MP në "Inxhinieri Ndërtimi", PNA mungon për vitet 2018 deri 2022. Kjo mungesë në takimin me PAE të Departamentit u justifikua me numrin e vogël të studentëve, çfarë mundëson mbikqyrjen e seminarëve dhe laboratorëve nga vetë lektorët e lëndëve. GVJ gjykon që për kushtet e PS MP në "Inxhinieri Ndërtimi" (pra me numër minimal studentësh) rruga e ndjekur është në plotësim të standardit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Shtojca 12 "Rregullorja për rekrutim stafi" - https://www.epoka.edu.al/
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program	Për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin çdo vit akademik të të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit, Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" në universitetin Epoka, është përgjegjëse zyra e Burimeve Njerzore, e cila nëpërmjet formularit informativ të Stafit, që plotësohet nga çdo antar i tij, disponon të dhënat e kërkuara. Kjo bëhet duke respektuar udhëzimet e komisionerit publik "Për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale". Ruajtja e të dhënave organizohet duke mbajtur dosje fizike për çdo antar të personelit si dhe dosje elektronike në sistemin interaktiv Epoka (https://eis.epoka.edu.al/login). GVJ i konsultoi burimet e të dhënave për këtë kriter dhe konstaton plotësimin e tij.

dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	<i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Shtojca 13- Udhëzues i stafit - https://ëëë.epoka.edu.al/
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues të biznesit e kompanive për realizimin e praktikave profesionale në universitetin Epoka organizohet e drejtohet nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni. Gjatë vizitës në këtë zyrë, GVJ konstaton që institucioni vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale dhe punimin e diplomës. Konkretisht Departamenti cakton staf mbikqyrës si për praktikën ashtu edhe për punimin e diplomës (kur studenti ka mesataren mbi 7.5). Koordinatorë për këtë PS ishte Dr. J.Keçi. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Annex 31- Staf_Guide_2022_2023 - https://www.epoka.edu.al/
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e	GVJ konstaton plotësimin e këtij standardi referuar fakti se për praktikën profesionale ka mbikqyrje nga Departamenti dhe studenti është i punësuar. Institucioni lidh kontratë me sipërmarrjen përkatëse. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Shtojca 13- Udhëzues i stafit - https://ëëë.epoka.edu.al/

detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.							
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që tek Universiteti Epoka personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies. GVJ, nisur edhe nga shqetësimet që kishte ekipi drejtues i fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë konstaton që ndjekja nga një numër shumë i vogël studentësh apo dhe ndërprerjet e këtij PS vijnë nga paplotësia e legjislacionit lidhur me licensimin e studentëve që përfundojnë studimet në këtë diplomë. GVJ rekomandon plotësimin e këtij boshllëku në legjislacion.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><th>Përmbushet pjesërisht</th><th>Përmbushet kryesisht</th><th>Përmbushet plotësisht</th></tr><tr><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Duke shqyrtur dokumentacionin e DVV si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që universiteti Epoka siguron ambiente për zhvillimin e aktivitetit mësimor e kërkimor shkencor, në varësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore. Konkretisht vihen në dispozicion 7 auditore, 1 sallë konferencash, 9 klasa për seminare dhe 9 laboratorë. Në këto ambiente, duke marrë në konsideratë specifikat e PS MP në "Inxhinieri Ndërtimi", aktivitetet zhvillohen në plotësim të standardeve të kërkuara. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konstaton që ky kriter plotësohet në nivel bashkëkohor. Të gjitha auditoret, klasat dhe laboratorit ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Në takimin me studentët, GVJ u informua që metodat e mësimdhënies për PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi” ishin edhe të larmishme dhe eficiente. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ vizitoi laboratorin e inxhinierisë së ndërtimit, i cili përdoret për studimin e materialeve të ndryshme, veçanërisht të betonit, termeteve dhe elementeve të tyre. Ky laborator vlerësohet si një nga asetet më të rëndësishme të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Në këtë laborator studentët kanë mundësinë të përdorin teknologjinë paisjet laboratorike për kërkime të ndryshme shkencore individualisht ose në grup. Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit ka një sipërfaqe totale prej 283 m². Laboratori përmban aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues edhe të programit të studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi”. Ndër të tjera, në laboratorin e inxhinierisë së ndërtimit njehsoheshin nëpërmjet eksperimentimit sa më poshtë: - Rezistenca në shtypje e betonit - Prova e shpimit të bërthamës së betonit - Rezistenca në tërheqje e shufrave të çelikut - Test i aktivitetit puzzolanik - Graviteti specifik i kursit dhe testi i agregatit të imët - Papastërtia organike e argjilës ose materialeve të tjera - Testi i Kohës së Hidratimit të Çimentos - Fortësia dhe qëndrueshmëria e çimentos - Testi i rënies - Zbulimi i përforsimit në strukturat RC. - Testi Schmidt Hammer

	- Testi Los Angeles etj. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Ky kriter plotësohet pasi universiteti Epoka vë në dispozicion të programeve të studimit 4 laboratorë të teknologjisë së informacionit, të paisura me PC dhe programe profesionale edhe për natyrën e PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi”. Disa nga këto programe integrohen edhe në paisjet e laboratorit të inxhinierisë së ndërtimit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë	Nga materialet e DVV dhe gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që universiteti Epoka ofron më shumë se 20 ambiente për aktivitetet mësimore e kërkimoro-shkencore (auditorë, klasa seminaresh e ushtrimesh, salla konferencash, sallë biblioteke etj). Këto mjedise janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të dedikuara për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse

me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit MP në "Inxhinieri Ndërtimi" dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së këtij programi studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstaton që literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (anglisht) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Ky konstatim mbështetet edhe nga studentët, në takimin që GVJ organizoi me to. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://ëëë.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 65- Librat IN - Shtojca 66- Procedurat e bibliotekës
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Drejtuesi i bibliotekës së universitetit Epoka e informoi hollësisht GVJ mbi fondin e pasur të bibliotekës, bashkëpunimin e frytshëm me Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit, masën e përdorimit të literaturës nga studentët, konsiderimin e sugjerimeve e kërkesave të pedagogëve dhe studentëve si dhe dobinë e abonimit nga institucioni tek libraria digjitale JSTOR <i>Referenca:</i>

	-RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 65- Librat IN - Shtojca 66- Procedurat e bibliotekes
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Universiteti Epoka ka një bibliotekë me sipërfaqe prej 400 metra katror. Qëllimi i saj është për të mbështetur aktivitetet arsimore, shkencore dhe kërkimore të stafit akademik dhe të studentëve. Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës, GVJ konstaton që ajo përbëhet nga tri njesi, një sallë leximi me një kapacitet prej 100 vendesh, pjesën e Bibliotekës me rreth 25000 libra, një qendër kërkimore me bibliotekë on-line dhe njësinë administrative të Bibliotekës. Biblioteka garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë të fondit, ofertës dhe ambienteve të saj edhe nga studentët e programit të studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi”. Nga biseda me studentët GVJ u informua që ata ishin të kënaqur me shërbimin e bibliotekës. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 65- Librat IN - Shtojca 66- Procedurat e bibliotekes
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në bibliotekën e universitetit Epoka, GVJ konstaton që ajo ishte e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi”. Kapaciteti i bibliotekës arrin deri në 100 vende ndërsa fondi fizik përbëhet prej rreth 25000 libra. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 65- Librat IN - Shtojca 66- Procedurat e bibliotekes

Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Ky kriter plotësohet nëpërmjet abonimit që ka bërë institucioni në librarine dixhitale JSTOR. Burime të tjera në dispozicion të stafit dhe të studentëve janë edhe Cambridge Journals online, IOP Science si dhe depon dixhitale Dspace, nga ku mund të aksesohen të gjitha burimet akademike dixhitale kombëtare e ndërkombëtare. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 65- Librat IN - Shtojca 66- Procedurat e biblotekes
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që biblioteka është e paisur me programe kompjuterike dhe teknologji të tjera, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët që e frekuentojnë atë. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 65- Librat IN - Shtojca 66- Procedurat e biblotekes
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Në universitetin Epoka biblioteka qëndron e hapur prej orës 08.30 deri në orën 16.30. Nga studentët e PS MP në "Inxhinieri Ndërtimi", të cilët e zhvillojnë mësimin pasdite, biblioteka shfrytëzohej sipas nevojave në orarin e punës së saj, por edhe nëpërmjet komunikimit me personelin e bibliotekës, për të krijuar mundësi të posaçme frekuentimi. Gjatë takimit me studentët ata pohuan për GVJ se ishin të kënaqur me shërbimet e bibliotekës. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 65- Librat IN - Shtojca 66- Procedurat e biblotekes
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të	Në takimet me personelin akademik dhe studentët si dhe gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u informua për cilësinë e fondit fizik dhe fondit

programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	online të saj. Ata pohuan që fondi përditësohej në mënyrë të vazhdueshme dhe se përdorimi i tij ishte efektiv në plotësimin e nevojave, kryesisht me literaturë profesionale (libra dhe revista). Sugjerimet dhe kërkesat e tyre përcilleshin edhe në department edhe direkt tek personeli i bibliotekës dhe merreshin në konsideratë prej tyre me përparësi. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 65- Librat IN - Shtojca 66- Procedurat e bibliotekës			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që programi i studimit "MP në "Inxhinieri Ndërtimi" përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme etj).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet	Universiteti Epoka disponon sistemin e menaxhimit EIS (Europa Interactive System) nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim. Çdo student ka llogarinë e tij të dedikuar në këtë system. Në takimin me studentët, GVJ u informua

me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	që ky system funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe i plotëson të gjitha kërkesat për shërbimet që u nevoiten atyre. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://ëëë.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse -Shtojca 71 – Udhëzues i studentëve për sistemin interaktiv Epoka (EIS) -Shtojca 72- Shërbimet e Zyrës ICTC
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi EIS administron edhe informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi”. Në takimin me personelin akademik, GVJ u informua që ky sistem funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe i plotëson të gjitha kërkesat për shërbimet që u nevoiten atyre. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse -Shtojca 71 – Udhëzues i studentëve për sistemin interaktiv Epoka (EIS) -Shtojca 72- Shërbimet e Zyrës ICTC
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Duke qenë se sistemi EIS shërben si sistem i menaxhimit të brendshëm në universitetin Epoka, ai siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi” <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse -Shtojca 71 – Udhëzues i studentëve për sistemin interaktiv Epoka (EIS) -Shtojca 72- Shërbimet e Zyrës ICTC
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të	Sistemi i menaxhimit EIS është i instaluar në platformën Google, arrihet nëpërmjet adresës së dedikuar për çdo individ dhe përmban

integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	module insertimi, leximi dhe editimi, të cilat mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse -Shtojca 71 – Udhëzues i studentëve për sistemin interaktiv Epoka (EIS) -Shtojca 72- Shërbimet e Zyrës ICTC
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit EIS garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Informacionet jepen nëpërmjet domenit https://www.epoka.edu.al/, i cili i afishon ato në rubrika të posaçme. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse -Shtojca 71 – Udhëzues i studentëve për sistemin interaktiv Epoka (EIS) -Shtojca 72- Shërbimet e Zyrës ICTC
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Universiteti Europa ka domenin e tij në internet, platforma google, e cila arrihet në adresën https://www.epoka.edu.al/. Në këtë adresë gjenden të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në rang institucioni, njësisht kryesore, njësisht përgjegjëse, programesh studimi etj. Të gjitha publikimet në këtë faqe janë në gjuhën anglisht dhe shqip. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse -Shtojca 71 – Udhëzues i studentëve për sistemin interaktiv Epoka (EIS) -Shtojca 72- Shërbimet e Zyrës ICTC

Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit institucional ESI dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar DVV dhe vizitës në Universitetin Epoka, GVJ konstaton që ky institucion harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e njësisë bazë përbërse të tij, ku përfshihet edhe Departamenti i Inxhinjerisë si njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit MP në "Inxhinieri Ndërtimi". Raporti financiar dhe plani mbështetës hartohen çdo vit duke marrë në konsideratë të gjitha shpenzimet e vitit të kaluar dhe të gjitha nevojat e kërkesave për vitin në vazhdim. Procedura që ndiqet është konform dispozitave ligjore që përcaktojnë raportimet mbi shpenzimet, të ardhurat dhe planifikimin e buxhetit. Buxheti miratohet nga Bordi i Administrimit. Duke marrë në konsideratë përvojën e krijuar nga ky institucion, buxhetin e pavarur të tij si dhe produktet e realizuara në vite, GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://ëëë.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Burimet e financimit në universitetin Epoka janë: tarifat e studentëve (kryesisht), projektet kërkimore ndërkombëtare dhe fonde të tjera kërkimore kombëtare e ndërkombëtare. Të gjitha fondet e siguruar shërbejnë për financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, e shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, e shpenzimeve për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, pagesën e detyrimeve financiare etj. Të gjitha këto shpenzime i shërbejnë realizimit të programeve të studimit. Duke marrë në konsideratë që peshën kryesore të financimit të këtij Programi Studimi e përbajnë tarifat e studentëve, GVJ gjykon që me frekuentimin tepër të vogël nga ana e studentëve e këtij PS apo mbylljen e PS për mungesë studentësh mbajtja hapur e këtij PS është jo efiçentë në pikpamje të dobisë ekonomike. Drejtuesit e Fakultetit dhe të Departamentit e informuan GVJ që mbajtja hapur e këtij PS bëhet për të kënaqur kërkesën e atyre që nuk plotësojnë kushtet për frekuentimin e diplomës Msc në “Inxhinieri Ndërtimi me Profile”. Sidoqoftë perspektiva e këtij PS pa rregullimet e domosdoshme ligjore do të jetë mbyllja e tij. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Universiteti Epoka është pjesë e shoqërisë aksionere “Turgut Ozal Sh.a”. Kjo shoqëri kryen auditimin e jashtëm vjetor financiar në lidhje me situatën financiare dhe harton një raport të detajuar, i cili gjendet në zyrat qendrore të kompanisë. Ky raport përmban gjithë analizën e të dhënave për shpenzimet dhe të ardhurat e kompanisë. GVJ gjykon plotësimin e këtij kriteri. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse	Gjatë vizitës në universitetin Epoka, GVJ u informua që ky institucion raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse, Departamentin e Inxhinierisë, për programin e studimit MP në

për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	“Inxhinieri Ndërtimi”, mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse		
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Referuar RVB, GVJ u informua që dokumenta të tillë si “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Pasqyra e performancës”, buxheti vjetor institucional etj përmbajnë tregues financiar që dëshmojnë qëndrueshmërinë financiare të institucionit për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Sa i përket PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi” siç e theksuam, mungesa e numrit të studentëve do të çojë në mbylljen e tij. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse		
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka në stadin aktual garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. GVJ gjykon që në perspektivë, për PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi” mund të ketë mbyllje të tij për shkak të mungesës së studentëve apo një numri tepër minimal të kërkesave për të.		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Referuar DVV, RVB, takimeve gjatë vizitave në institucion si dhe portalit të dedikuar Universitetit Epoka , GVJ konstaton që Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Dokumentet bazë si “Statuti i universitetit Epoka” “Rregullorja bazë”, “Rregullorja e Fakultetit” etj përmbajnë politikat dhe procedurat që ndiqen gjatë gjithë kohës së studimeve (kriteret e pranimin, plani mësimor, syllabuset, detyrimet dhe të drejtat etj). Të gjitha këto politika dhe procedura publikohen për tu vënë në dispozicion të të interesuarve. Për studentët, në veçanti, njohja me politikat dhe procedurat fillon me javën orientuese. Në këtë kohë ai “miqësohet” edhe me ambientet mësimore si dhe shërbimet që ofron veçmas institucioni. E gjithë ecuria e procesit të diplomimit për çdo student dokumentohet dhe ruhet në institucion, pa afat. Në takimin me studentët GVJ u informua se ata i njihnin këto politika dhe procedura dhe konfirmonin që zbatimi i tyre ishte në dobi të gjithë aktivitetit të tyre në institucion. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 2- Rregullorja e fakultetit
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për	Jo vetëm në dokumentacionin e konsultuar por edhe në takimet në insitucion, kryesisht gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton që politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë pra edhe për studentët e programit të studimit Master Profesional në “Inxhinieri

studentë dhe studentët e programit të studimit.	Ndërtimi”. Si të drejtat ashtu edhe detyrimet ishin të njohura nga studentët edhe nëpërmjet dokumentacionit të publikuar nga institucioni, edhe nga veprimtaria konkrete që zhvillohej gjatë kohës së studimeve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të konsulencës nga zyrat përkatëse. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 2- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Plotësimi i këtij kriteri konstatohet në gjithë dokumentacion e publikuar në faqen e dedikuar në internet për institucionin. Universiteti Epoka pranon në të gjitha programet e studimit studentë vendas dhe të huaj bazuar në kuotat e studentëve, të propozuara nga Bordi administrativ i Universitetit dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit. Përpos kriterëve të tjera si nota mesatare e specifikuar për studentët që vijnë nga programi bachelor i Universitetit Epoka dhe nga programi bachelor i universiteteve të tjera. Niveli i aftësisë në gjuhën angleze, është kriter i veçantë për të përthithur studentë sa më cilësorë, për të cilën universiteti publikon edhe politikën e tij lidhur me dhënien e bursave. Procesi i bashkëpunimit me maturën shtetërore bazohet në përcaktimet ligjore të Rregullores së Maturës Shtetërore (Nr, prot 12213/1, datë 23/11/2018) si dhe dispozitave të veçanta rregulluese. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 2- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe	GVJ konsultoi gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion (DVV, RVB, Statutin e Universitetit, Rregulloren e fakultetit, publikimet në

përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	faqen e internetit) dhe konstaton që kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Faqja zyrtare në internet e universitetit Epoka në adresën https://www.epoka.edu.al/ ofron të gjitha informacionet e kërkuara. Po ashtu universiteti ka të organizuar në zyra të posaçme si Zyra e Pranimit të studentëve, Zyra e Koordinimit dhe Komisioni për Marrëdhëniet me Studentët, të gjitha shërbimet e kërkuara. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 2- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Duke iu referuar dokumentacionit të konsultuar, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe publikimeve në faqen zyrtare https://www.epoka.edu.al/, GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri. Të gjitha kërkesat referohen në dispozitat ligjore dhe interesat e institucionit për të tërhequr kontigjente sa më cilësorë. Për kandidatët e pranuar shërben Zyra e pranimit, e cila u jep atyre informacione të detajuara për universitetin dhe njësitë e tij si dhe për programin e studimit përkatës. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 2- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik	Për të siguruar një përzgjedhje sa më të qëlluar të kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, GVJ u informua që universiteti Epoka është partner në projektin IDEA,

kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	që ka për objekt përmirësimin e aksesit, krijimin e kushteve të mësimi dhe zhvillimin e mundësive të punësimit për këtë kategori kandidatësh. Po ashtu Institucioni ka krijuar edhe një staf që vlerëson kapërcimin e pengesave që lidhen me këto kandidatë. Ky staf funksionon për çdo njësi. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 2- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Për kandidatët që vijnë nga shtetet e tjera dhe kërkojnë të përfshihen në PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi”, specifika e pranimit të tyre qëndron tek disponimi i diplomës Bachelor të ekuivalentuar, zotërimi në nivelin B2 të gjuhës angleze vlerësuar nga një listë provimesh të miratuar nga institucioni si dhe vlera e mesatares së ekuivalentuar në cilësinë e notës së vendosur për pranimet e kandidatëve vendas. Në gjithë historikun e egzistencës së PS “MP në Inxhinieri Ndërtimi” nuk ka patur studentë nga shtete tjera. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 2- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për	Për kandidatët që u përkasin shtresave në nevojë universiteti Epoka jep bursa sociale. Në këtë kategori përfshihen: • Fëmijë të policëve të vrarë në krye të detyrës; • Jetimë që vijnë nga familje me të ardhura të ulta; • Studentë që i përkasin komunitetit rom/egjiptian; • Sportistë me rezultate të larta në kategoritë sportive përkatëse;

zhvillimin ekonomik të vendit.	- Nxënës nga Bashkia Vorë. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 2- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve si dhe diplomimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Për plotësimin e këtij kriteri, GVJ konsultoi fillimisht “Rregulloren bazë të Universitetit Epoka” dhe “Guidën e studentit” dhe konstaton që ata japin një informacion të plotë e të qartë mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Informacioni merr në konsideratë vlerësimin me nota në sistemin që përdor institucioni. Ky shërbim merret edhe nga interneti, ku gjendet i përfshirë në sistemin interaktiv të universitetit Epoka EIS. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze.

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<i>-Shtojca 2- Rregullorja e fakultetit</i> Në dokumentacionin bazë të institucionit jepen informacionet që lidhen me kriteret dhe procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Këto informacione merren edhe tek zyrat përkatëse të institucionit si Zyra e Koordinimit të Studentëve dhe Komisionit për Marrëdhëniet me Studentët apo tek sistemi i dedikuar EIS. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 37- Direktiva per transferimin e studenteve
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Informacioni për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive jepet qysh në ditët e javës orientuese. Po ashtu në “Guidën e studentit” ata gjejnë informacionet e kërkuara për këtë rubrikë. Më tej informacionet merren edhe në faqen zyrtare të institucionit në internet në adresën https://www.epoka.edu.al duke kërkuar profilin përkatës të studimit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit jepen në nenin 41 të “Rregullores për programet e studimit të ciklit të dytë” shtojca 3 dhe neni 56 i “Rregullores bazë të Universitetit Epoka”, shtojca 1.1. Në aspektin praktik studentët ndihmohen edhe nga Këshilltari i Fakultetit. Ja një informacion i nxjerrë nga adresa https://cen.epoka.edu.al/kreu-master-shkencor-702-704.html për tezën e masterit:

	Temat e tezës zhvillohen individualisht nga studenti në konsultim me këshilltarin e fakultetit. Për tu përgatitur për hulumtimet dhe shkrimin e tezës së tyre, studentët duhet të plotësojnë një kurs që ofron mësim në metodat e hulumtimit dhe shkrimit akademik. Komiteti i tezës përbëhet nga tre anëtarë, zakonisht anëtarë të Departamentit të inxhinierisë së ndërtimit në Universitetin Epoka. Studentët gjithashtu mund të ftojnë një lexues nga jashtë për të marrë pjesë në komitetin e tezës. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në universitetin Epoka ky kriter plotësohet duke organizuar javën e orientimit të studentëve, duke i pajisur ata me guidën e studentit si dhe duke i rekomanduar studentët në rubrikat përkatëse të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 7- Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Epoka vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit MP në "Inxhinieri Ndërtimi". informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Referuar dispozitave ligjore, statutit të Universitetit Epoka, Rregullores bazë të UE”, “Rregullores së fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë” etj, GVJ vlerëson që studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton që ata i kanë të gjitha informacionet e kërkuara. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 7- Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët njihen me planin mësimor të profilit të tyre, syllabuset e çdo lënde, veprimtaritë përkatëse mësimore (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyra) dhe procedurat e vlersimit të njohurive. Këto informacione u transmetohen atyre në mënyrë të vazhdueshme qysh me fillimin e programit të studimeve e deri në diplomim. Sipas profilit të tyre, studentët udhëzohen të gjejnë këto informacione edhe në faqen zyrtare të institucionit. Gjatë takimit me studentët GVJ konstaton që ata i zotërojnë të gjitha informacionet e kërkuara. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023

	-Shtojca 7- Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës studentët informohen mbi mundësitë e punësimit si dhe mbështeten institucionalisht për orientimin drejt tregut të punës. Sipas statistikave të institucionit për punësimin rezulton që të gjithë studentët që kanë mbaruar këtë PS nga viti 2018 deri në vitin 2023 (gjithsej 6 studentë) janë të punësuar. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 7- Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Të gjithë studentët e PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi”. kanë akses në sistemin interaktiv të universitetit Epoka EIS, ku gjejnë të gjitha informacionet për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, si dhe logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Po ashtu, në dispozicion të tyre janë edhe zyrat përkatëse në institucion të cilat i ofrojnë këto shërbime sa herë u kërkohen nga të interesuarit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse -Shtojca 71 – Udhezues i studenteve per sistemin EIS -Shtojca 72 – Sherbimet e Zyres ICTC
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i	Ky kriter plotësohet me aksesin që kanë të gjithë studentët e PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi”. në sistemin EIS. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 71 – Udhezues i studenteve per sistemin EIS -Shtojca 72 – Sherbimet e Zyres ICTC

arritshëm nga studentët edhe në distancë.				
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit MP në "Inxhinieri Ndërtimi". informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konsultoi tre regjistrat që duhet të disponohen në këtë sekretari sipas Udhezimit Nr.16, datë 08.07.2019 për "PAJISJEN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË ME REGJISTRIN THEMELTAR TË STUDENTËVE, REGJISTRIN E ARRITJEVE AKADEMIKE DHE REGJISTRIN E LËSHIMIT TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE". Nga shqyrtimi i tyre, GVJ konstaton që Universiteti Epoka disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit MP në "Inxhinieri Ndërtimi". <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 41 – Zyra e Rregjistrimit. Procedurat e rregjistrimit studenteve - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse -Shtojca 71 – Udhezues i studenteve për sistemin EIS -Shtojca 72 – Sherbimet e Zyres ICTC
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të	Plotësimi i këtij kriteri dëshmohet nga shqyrtimi i regjistrave që ndodhen në sekretarinë mësimore. GVJ konstaton që regjistrat

regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	plotësohen rregullisht, me shënime të qarta, pa korregjime dhe konform udhëzimit Nr.16, date 08.07.2019. Numri i studentëve për dy vitet akademike është: 2021-2022:1 student 2022-2023:2 studentë <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 41 – Zyra e Rregjistrimit. Procedurat e rregjistrimit studenteve
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konsultoi sistemin e interaktiv të informacionit EIS si dhe sistemin brendshëm të menaxhimit LMS dhe konstaton që të dhënat për studentët menaxhohen të plota, të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Çdo student kishte adresë të dedikuar për këto sisteme. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 71 – Udhezues i studenteve per sistemin EIS
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Plotësimi i këtij kriteri realizohet nëpërmjet funksionimit të grupit të auditimit të brendshëm, i cili kryen auditime periodike dhe krijohet me vendim të rektoratit. Auditimet kryhen për çdo njësi akademike dhe administrative. Gjatë këtij auditimi vlerësohet dhe dokumentohet gjendja dhe saktësia e informacionit dhe të dokumentacionit, që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Grupi përgatit raportin e auditimit të brendshëm, i cili i jepet rektoratit dhe njësive përkatëse për plotësimin e boshllëqeve dhe parregullsive të konstatuara. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 86 -Auditimi i brendshem 2019. Raportet e mosperputhshmerise

Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në aneksin 56 të DVV është listuar Rraporti Vjetor i Departamentit të Inxhinierisë së Ndërimit për PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi”, GVJ e konsultoi këtë dokument që përmban cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 86 -Auditimi i brendshëm 2019. Raportet e mosperputhshmerise - Shtojca 80- Tabelat përmbledhëse			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Epoka mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në shqyrtim të DVV, GVJ konsultoi të gjitha dokumentat që lidhen me përfshirjen dhe angazhimin e studentëve, përkatësisht përfaqësuesve të tyre, në organet vendimmarrëse e këshilluese mbështetur me akte ligjore dhe rregullatore të Universitetit Epoka. Në Statutin e institucionit thuhet që studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse të universitetit, duke përmbushur kështu një detyrim ligjor që rrjedh nga ligji për arsimin e lartë 80/2015. Në zbatim të këtij përcaktimi, në Universitetin Epoka funksionon Këshilli Studentor, që përbëhet nga studentë të zgjedhur nga vetë studentët. Këshilli Studentor angazhohet për të përcjellë kërkesat e studentëve në Administratën e Universitetit. Objektivi bazë i KS është të sigurojë zhvillimin akademik të studentëve dhe pritjen e tyre

	në aspektin social e individual. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre (kryetarin dhe nënkryetarin e Këshillit Studentor) në senat. Nënkyetari i Këshillit Studentor për çështjet e sigurimit të cilësisë është antar i Komisionit Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. Nënkyetari i Këshillit Studentor për etikën është antar i Bordit të Etikës. Dy antarë të Këshillit Studentor janë antarë të Komisionit të përhershëm të Marrdhënieve Studentore. Një student është në përbërje të grupit për hartimin e RVB. Referuar këtyre angazhimeve të studentëve GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 44- Statuti i Keshillit Studentor
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej për mendimin që kishin ata lidhur me “forcën” e zërit të tyre në organet ku ata përfaqësoheshin dhe konstaton që vlersimi i tyre ishte i lartë. Pra, ata ndjeheshin të përfaqësuar plotësisht në vendimmarrjen, këshillimin apo vlerësimin mbi procesin akademik. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 44- Statuti i Keshillit Studentor
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të	Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej për rolin e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Në përgjigje të këtij interesimi, studentët konfirmuan angazhimin e tyre në rishikimin e planit mësimor. <i>Referenca:</i> -RVB

rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	-Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 44- Statuti i Keshillit Studentor		
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej sa konsiderohej dhënia e mendimit të tyre për barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, ankimimit të rezultatit si dhe rishikimit e reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Në përgjigje të këtij interesimi ata u përgjigjen për konsiderimin e plotë të të gjithë problematikave që ngrinin lidhur me vlersimin. Ata pohuan njohjen dhe ndjekjen e të gjitha procedurave që kanë të bëjnë me vlersimin. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 44- Statuti i Keshillit Studentor		
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Procedurat dhe njësitë e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në Universitetin Epoka janë ngritur e funksionojnë mbi bazën e Statutit të Universitetit, “Rregullores Bazë” të tij si dhe dispozitave të tjera ligjore në zbatim të përcaktimeve të ligjit 80/2015. Këshilli Studentor dhe Dekanati i Studentëve kanë për detyrë respektivisht të përfaqësojnë studentët dhe të përcjellin në organet kompetente të institucionit problemet që i shqetësojnë dhe të marrin përsipër zgjidhjen e tyre. Ata i informojnë studentët për përcjelljen dhe realizimin e kërkesave të tyre. Në takimin me Dekanin e Studentëve ai e informoi GVJ për mënyrën se si vilen kërkesat e studentëve me anë të formularëve. Ai referoi ekzistencën e 2 formularëve: formularit të çështjeve akademike dhe formularit të çështjeve administrative, ku studentët paraqesin mendimet, sugjerimet dhe kërkesat e tyre. Në dispozicion të informimit e shërbimit të studentëve janë edhe zyrat e posaçme si Zyra e Rregjistrimit, Zyra e Koordinimit të Studentëve, Zyra e Planifikimit të Karrierës. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 44- Statuti i Keshillit Studentor
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi i posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit në Universitetin Epoka lidhet më së pari me aksesin në Sistemin Interaktiv, EIS. Në këtë sistem çdo student ka adresë të dedikuar, e cila funksionon mbi bazën e adresës së E-Mail-it në domenin https://www.epoka.edu.al/. Në adresën e E-Mail-it dhe në rubrikat e sistemit EIS studenti informohet, merr këshilla, ndjek përparimin e tij dhe asistohet për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion

	- https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 44- Statuti i Keshillit Studentor -Shtojca 41 – Zyra e rregjistrimit. Procedurat e rregjistrimit te studenteve
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjatë vizitës në Universitetin Epoka, GVJ u takua dhe me përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës për tu njohur konkretisht me aktivitetin e saj në dobi të informimit dhe orientimit të studentëve, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. GVJ konstaton se shërbimet e kësaj zyre janë efektive dhe me interes për studentët. Një aktivitet me mjaft peshë në këtë aspekt ishte edhe Panairi i Karrierës, ku nëpërmjet pjesmarrjes së bizneseve (në sezonin e vitit të kaluar kishin marrë pjesë 105 biznese. Po kështu një numër mjaft i madh biznesësh muarën pjesë dhe në panairin e karrierës së këtij viti që u zhvillua me dt. 5 mars) ku shkëmbeheshin interesimet e të dy palëve në lidhje me kërkesat dhe ofertat për punësim. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 44- Statuti i Keshillit Studentor
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e	GVJ konsultoi statistikën e Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe mësoi që shkalla e përgjithshme e punësimit është 100%. Natyrisht ky tregues për PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi” nuk është sinjifikativ pasi numri i gjithë të diplomuarve që nga viti 2018 është 6 të diplomuar. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/

autoriteteve drejtuese përkatëse.	- Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka - Shtojca 2- Rregullorja baze. -Shtojca 3- Rregullorja e fakultetit -Shtojca 61- Guida e Studentit 2022-2023 -Shtojca 44- Statuti i Keshillit Studentor -Shtojca 80- Tabelat permbledhese			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së	Duke shqyrtuar DVV, RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti Epoka disponon “Manualin e Sigurimit të Cilësisë në Universitetin Epoka” dhe “Politikat për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit”. Në dokumentin e strategjisë së institucionit për vitet 2018-2022 thuhet: “prioriteti strategjik i institucionit është ofrimi i një mjedisi me cilësi të lartë për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Fuqia e Universitetit Epoka qëndron në aftësinë e tij për të ofruar programe studimi që përdorin teknologjitë më të avancuara të mësimdhënies”. Realizimin e kësaj strategjie e gjen qysh tek mjediset ku zhvillohet aktiviteti mësimor e kërkimor-shkencor, në kompozimin e planit

studimeve, lëndëve/moduleve.	mësimor, në hartimin e syllabuseve të çdo lënde, në rekrutimin e një personeli akademik dhe administrativ me nivel të lartë kualifikimi, në cilësinë e të gjitha shërbimeve, në thithjen e studentëve cilësorë dhe në shkallën e lartë të punësimit të tyre në tregun e punës. Në takimin me studentët, GVJ u informua për vlersimin e tyre ndaj metodave të mësimdhënies duke shprehur konsideratat më të larta. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Njësia kryesore dhe njësia bazë e PS MP në "Inxhinieri Ndërtimit" janë përkatësisht "Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë" dhe "Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit". Këto struktura përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma monitorimi dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.. Për këtë qëllim shërbejnë kryesisht Anketat e Vlerësimit të Personelit dhe Vizitat në Auditore. Formularët plotësohen online dhe rezultatet i nxjerr sistemi në % për çdo përgjigje. Shefi i Departamentit i pasqyron këto të dhëna në raportin vjetor. Në bazë të rezultateve të këtyre formave merren masa për përmirësime duke ia referuar personelit problematikën e konstatuar. Po ashtu njësitet përgjegjësi organizojnë edhe trajnime kur kërkohen përdorime inovative si psh "trajtimi për edukimin dixhital", organizuar nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Zyra e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka -Shtojca 2- Regullorja Baze -Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e	Universiteti "Epoka" garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve,

studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.

si dhe mundësinë e trajtimit të ankimimeve më së pari nëpërmjet “Anketës së Vlersimit të Instruktorëve të Kursit” e cila plotësohet nga çdo student në fund semestri dhe përbëhet nga 14 pyetje ku jepen përgjigje lidhur me zhvillimin e syllabuseve, komunikimin me auditorin, metodën e mësimdhënies, vlersimin e performancës, përdorimin e kohës në leksione, seminare e laboratore etj. Rezultatet e anketimeve përfshihen në raportin vjetor që përgaditet nga Shefi i Departamentit. Në takimin me studentët, GVJ u informua që, nga ana e strukturave përgjegjëse merreshin të gjitha masat për zgjidhjen e ankesave dhe përmirësimin e dobësive të konstatuara.

Referenca:
-RVB
-Shënime nga vizita në Institucion
- <https://www.epoka.edu.al/>
-Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë
-Shtojca 33- Politika e cilësisë
-Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e KPSC

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

Publikimi i rezultateve të të gjitha gjetjeve të anketimit bëhet në faqen zyrtare të Universitetit “Epoka” si “Raport vjetor”. GVJ e konsultoi faqen zyrtare të institucionit dhe konstaton publikimin e të dhënave e rezultateve të anketimit si më poshtë:

Nr.	Pyetja	Vlerësimi mesatar për semestrin I	Vlerësimi mesatar për semestrin II
1.	Përmbledhja dhe objektivat e lëndës ishin paraqitur qartë në syllabus	3.56	3.52
2.	Libri dhe/ose materialet e tjera të leximit të ndihmonin për të kuptuar temën	3.51	3.49
3.	Lënda rriti dijet dhe interesin tim mbi temën	3.48	3.44
4.	Metodat e mësimdhënies në këtë lëndë ishin të përshtatshme	3.49	3.46
5.	Pedagogu ishte përgatitur mirë për leksionet	3.58	3.53
6.	Pedagogu tregoi vëmendje për ecurinë time	3.36	3.38
7.	Pedagogu ishte i disponueshëm për të ndihmuar jashtë auditorit	3.46	3.47
8.	Pedagogu vinte në kohë në auditor	3.6	3.55
9.	Pedagogu vinte rregullisht në leksione	3.62	3.57
10.	Pedagogu përdori në mënyrë të përshtatshme materialet e lëndës në lidhje me temat	3.54	3.5
11.	Pedagogu e përdori gjuhën e mësimdhënies në mënyrë të efektshme	3.54	3.5
12.	Pedagogu e vlerësoi punën time në mënyrë të drejtë	3.5	3.46
13.	Pedagogu pati dialog efektiv me studentët gjatë leksioneve	3.5	3.47
14.	Pedagogu e përfshiu dhe motivoi klasën shumë mirë	3.45	3.42

Referenca:
-RVB
-Shënime nga vizita në Institucion
- <https://www.epoka.edu.al/>
-Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë

	<i>-Shtojca 33- Politika e cilësisë</i> <i>-Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, GVJ konstaton që mbi bazën e rezultatit për çdo pedagog vlerësohet performanca e mësimdhënies në 5 nivele. Konkretisht niveli 1 (U) vlerësohet si “i pakënaqshëm” kur “nota” e studentëve është më e vogël se 2.5. Niveli 2 (I) vlerësohet si “është i nevojshëm përmirësimi” kur “nota” e studentëve është më e vogël se 3.0. Niveli 3 (ME) vlerësohet si “përmbush pritshmëritë” kur “nota” e studentëve është 3.0-3.5. Niveli 4 (EE) vlerësohet si “tejkalon pritshmëritë” kur “nota” e studentëve është 3.5-3.79. Niveli 5 (E) vlerësohet si “i jashtëzakonshëm” kur “nota” e studentëve është > 3.8. GVJ gjykon që kjo mënyrë vlersimi nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. <i>Referenca:</i> <i>-RVB</i> <i>-Shënime nga vizita në Institucion</i> <i>- https://www.epoka.edu.al/</i> <i>-Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>-Shtojca 33- Politika e cilësisë</i> <i>-Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me	GVJ konstaton që në Universitetin Epoka është ngritur e funksionon Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me nenin 103 të Ligjit nr. 80/2015. Mbi këtë bazë janë hartuar aktet rregullatore të institucionit si Statuti, Rregullorja Bazë, Rregulloret e Njësive Kryesore, Rregulloret e Programeve të Studimeve etj, të cilët kanë prodhuar strukturën e cilësisë që, në Komisionin e

parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë përfshin Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Zvillimit të Kurrikulave, Bordin e Provimeve dhe Bordin e Vlerësimit të Performancës Akademike. Kjo strukturë ka si produkt funksionimin, zhvillimin dhe realizimin e procesit mësimor e kërkimoro-shkencor me nivel të lartë cilësie. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka -Shtojca 2- Regullorja Baze -Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga shqyrtimi i RVB, DVV (dokumentet “Plani Strategjik për Inxhinierinë e Ndërtimit” si dhe të gjitha produktet e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, GVJ gjykon që institucioni e ka të të ngritur dhe e mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. E gjithë struktura e tij zbaton strategjinë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë edhe studentët edhe ekspertë të jashtëm si anëtarë të kësaj strukture. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka -Shtojca 2- Regullorja Baze -Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë	Akreditimet nga ASCAL të Universitetit Epoka janë kryer sipas dispozitave ligjore për arsimin e lartë në vendin tonë. Gjetjet dhe rekomandimet e këtyre akreditimeve, mbështetur në treguesit e cilësisë të realizuar prej tij, kanë shërbyer në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë edhe për PS MP në Inxhinieri Ndërtimi”.

realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka -Shtojca 2- Regullorja Baze -Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Referuar DVV, RVB dhe vizitës në Universitetin Epoka GVJ konstaton përdorimin e treguesve të qartë për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore të institucionit. Këto tregues pasqyrohen në raportet periodike që harton institucioni dhe njësitë përbërse të tij. Ato janë të publikuar në adresën e faqes zyrtare të Universitetit Epoka https://www.epoka.edu.al/ , kështuqë mund të konsultohen prej cilitdo të interesuari, i cili pas konsultimit konstaton që ky institucion, mbështetur në treguesit cilësorë bën promovime nxitëse për arritjet më të mira edhe në programin e studimit MP në "Inxhinieri Ndërtimi". Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 1.1- Statuti i Universitetit Epoka -Shtojca 2- Regullorja Baze -Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC -Shtojca 86- Auditimi i brendshëm 2019. Raportet e mosperputhshmerise			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti "Epoka" harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konsultoi fillimisht DVV, që ka shërbyer si bazë e punës së Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e RVB dhe konstatoi që kjo dosje përmban dokumentat e përcaktuara në aktet ligjore për evidentimin e nivelit të cilësisë në PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi”. Në vazhdim, gjatë vizitës në institucion, u kërkuar edhe disa dokumenta shtesë. Në shqyrtim dhe në analizë të gjithë këtyre materialeve, GVJ konstaton që dokumentat e prodhuara i shërbejnë akreditimit të PS. <i>Referenca:</i> RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit -Shtojca 7- Regullorja për programet e studimit të ciklit të dytë -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC -Shtojca 86- Auditimi i brendshëm 2019. Raportet e mosperputhshmerise
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga	GVJ konstaton që në RVB, të prodhuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) si dhe në gjithë dokumentacionin e prodhuar nga zbatimi i akteve rregulluese ligjore përfshihen rezultate vlersimi, motivohen praktikave dhe arritjet më të mira, pasqyrohen masat e marra për përmirësimin në vijim të cilësisë si dhe motivohen arritjet më të mira në procesin mësimor dhe kërkimor shkencor nga i gjithë personeli akademik i angazhuar në PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi”. <i>Referenca:</i> RVB -Shënime nga vizita në Institucion

personeli akademik dhe studentët.	- https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit -Shtojca 7- Regullorja per programet e studimit te ciklit te dyte -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC -Shtojca 86- Auditimi i brendshem 2019. Raportet e mosperputhshmerise
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstaton që vizitat në auditore, si një metodë e drejtpërdrejtë, evidentojnë probleme që kanë të bëjnë me komunikimin e pedagogëve me auditorin, aktivizimin e studentëve, përdorimin e kohës në mësimdhënie etj. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luan edhe auditimi i brendshëm që kryhet nga departamenti. Organizimi nga ana e institucionit i kurseve të kualifikimit, përbën një masë preventivuese për mënjanimin e dobësive që vinë nga paqartësi metodike e procedurale. <i>Referenca:</i> RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC -Shtojca 86- Auditimi i brendshem 2019. Raportet e mosperputhshmerise
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e	GVJ konstaton që metoda të tilla të tërthorta vlersimi si “Anketa për Vlersimin e Instruktorëve të Kursit”, e cila plotësohet 2 herë në vit, në çdo fund semestri, me përmbajtjen e saj në 14 pika, evidenton edhe në gjerësi edhe në thellësi gjithë problematikën që lidhet me cilësinë e mësimdhënies, didaktikën, kurikulën etj. Kontaktet e vazhdueshme me Alumnin, edhe nëpërmjet anketës së posaçme që kryhet me antarët e tij nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit, si dhe organizimi i panairëve të karrierës. kontribuojnë po ashtu në përmirësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së PS. në Universitetin Epoka.Gjithashtu organizohen edhe anketime të tjera si ai mbi kënaqësinë e kompanisë apo ai mbi kënaqësinë e stafit, nga të cilët merren të dhëna që përdoren në

institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	rritjen dhe përmirësimin e cilësisë. Universiteti Epoka, me shkallën e lartë të punësimit të të diplomuarve të tij, ka luksin të tërheqë nga sipërmarrjet ku janë të punësuar kontigjentet e tij, konsiderata e vlersime që i shërbejnë institucionit në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>Referenca:</i> RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC -Shtojca 86- Auditimi i brendshëm 2019. Raportet e mosperputhshmerise			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Epoka monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të	Referuar Ligjit 80/2015 si dhe akteve rregullatore ligjore të institucionit që burojnë nga zbatimi i këtij ligji, Statutit dhe Rregulloreve të tij, GVJ konstaton që në Universitetin Epoka, në politikat dhe procedurat lidhur me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi”, parashikohet dhe garantohet përfshirja e aktorëve të brendshëm e të jashtëm. Kështu në organet që merren me sigurimin e cilësisë, si aktorë të brendshëm janë edhe studentët. Kontrolli i cilësisë bëhet periodikisht edhe nga ASCAL nëpërmjet akreditimeve.

cilësisë së programit të studimit.	<i>Referenca:</i> <i>RVB</i> <i>-Shënime nga vizita në Institucion</i> <i>- https://www.epoka.edu.al/</i> <i>-Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit</i> <i>-Shtojca 7- Regullorja per programet e studimit te ciklit te dyte</i> <i>-Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>-Shtojca 33- Politika e cilësisë</i> <i>-Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC</i> <i>-Shtojca 86- Auditimi i brendshem 2019. Raportet e mosperputhshmerise</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit përcaktohen të drejta dhe detyrime për të gjithë aktorët që merren me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në zbatim të këtyre përcaktimeve ligjore kryhen auditime të vazhdueshme, rezultatet e të cilave publikohen edhe në Raportin Vjetor të Institucionit. Gjatë vizitës në institucion GJV konstatoi që edhe njësitë edhe individët edhe studentët punonin me objektiva të qarta për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit “MP në Inxhinieri Ndërtimi”. Nisur nga realizimi i këtyre objektivave GJV gjykon që ky kriter për këtë PS plotësohet tërësisht. <i>Referenca:</i> <i>RVB</i> <i>-Shënime nga vizita në Institucion</i> <i>- https://www.epoka.edu.al/</i> <i>-Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit</i> <i>-Shtojca 7- Regullorja per programet e studimit te ciklit te dyte</i> <i>-Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë</i> <i>-Shtojca 33- Politika e cilësisë</i> <i>-Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC</i> <i>-Shtojca 86- Auditimi i brendshem 2019. Raportet e mosperputhshmerise</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik,	GJV, duke shqyrtuar DVV dhe RVB si dhe gjatë takimeve në institucion, gjykon që njësitë përgjegjëse për PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi”, “Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë”, “Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit” si dhe drejtuesit e tyre janë të angazhuar për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. <i>Referenca:</i> <i>RVB</i>

ndihmë akademike dhe administrative dhe studentëve të programit të studimit.	-Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit -Shtojca 7- Regullorja për programet e studimit të ciklit të dytë -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC -Shtojca 86- Auditimi i brendshëm 2019. Raportet e mosperputhshmerise
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Si aktorë të brendshëm në proceset e vlersimit të PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi” konsiderohen Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, stafi akademik, stafi administrativ si dhe studentët. Duke shqyrtuar DVV, GVJ konstaton që të gjithë këta aktorë janë përfshirë në procesin e vlersimit dhe detyrat që ata kanë kryer, kanë qenë të barazvlefshme në cilësi duke shmangur diskriminimin dhe pabarazinë. Referenca: RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 3- Regullorja e Fakultetit -Shtojca 7- Regullorja për programet e studimit të ciklit të dytë -Shtojca 32- Manuali i sigurimit të cilësisë -Shtojca 33- Politika e cilësisë -Shtojca 34-Regullorja për Organizimin dhe Funksionimin e KPSC -Shtojca 86- Auditimi i brendshëm 2019. Raportet e mosperputhshmerise
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Plotësimi i këtij kriteri për programin e studimit “MP në inxhinieri ndërtimi” sigurohet nëpërmjet përfshirjes në KPSC të një eksperti të jashtëm si dhe një përfaqësuesi nga studentët e diplomuar. Po ashtu aplikimi i një ankete për të tërhequr komentet e të diplomuarve mbi vlerën praktike të njohurive që ata marrin gjatë kohës së studimeve vlerësohet si një metodë efektive për përmirësimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Komente me vlerë japin edhe kompanitë ku janë të punësuar të diplomuarit e këtij programi studimi. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua për realizimin e këtyre procedurave dhe konstaton plotësimin e këtij kriteri.

Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit MP në “Inxhinieri Ndërtimi” janë dokumentuar në aktet ligjore e nënligjore të Universitetit Epoka. Institucioni ka interes që këto elementë të aktivitetit të tij të jenë transparente e të njihen gjerësisht. Për këtë, përveç botimeve në fashikuj të veçantë përfshirë në dokumentat bazë të institucionit ato janë publikuar edhe në faqen zyrtare të institucionit https://www.epoka.edu.al/. <i>Referenca:</i> RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ Shtojca 55- Raporti vjetor i KPSC. Shtojca 56- Raporti vjetor i Departamentit Shtojca 57- Raporti vjetor institucional
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Universiteti Epoka i ka botuar rezultatet e vlerësimeve MP në “Inxhinieri Ndërtimi” në kapituj të veçantë të përfshirë në dokumentat bazë të institucionit apo raportet vjetore si dhe në faqen zyrtare të institucionit https://www.epoka.edu.al/. Gjatë vizitës në institucion, kryesisht në takimin me Personelin Akademik, GVJ u interesua për respektimin e lirisë dhe etikës akademike dhe konstatoi respektimin e tyre. Po ashtu është respektuar dhe legjislacioni për ruajtjen e të dhënave personale. <i>Referenca:</i>

	<i>RVB</i> <i>-Shënime nga vizita në Institucion</i> <i>- https://www.epoka.edu.al/</i> <i>-Shtojca 2- Regullorja baze</i> <i>-Shtojca 2- Regullorja fakultetit</i> <i>-Shtojca 55- Raporti vjetor i KPSC.</i> <i>-Shtojca 56- Raporti vjetor i Departamentit</i> <i>-Shtojca 57- Raporti vjetor institucional</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në raportet vjetore, por edhe në analizat lidhur me rezultatet e vlerësimit, janë hartuar plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. GVJ konstaton që raportet e vlerësimit të jashtëm shqyrtohen nga drejtuesit e njësive përgjegjëse, përkatësisht programeve të studimit, të cilët kanë kompetencën dhe përgjegjësinë, në zbatim të detyrimeve ligjore, të hartojnë plane veprimi duke caktuar objektiva dhe afate konkrete. Plane veprimi hartohen edhe duke adresuar gjetjet e anketimeve si anketimet për vlersimin e instruktorëve të kursit, vlersimin e kënaqësisë së stafit apo të kënaqësisë së kompanisë. <i>Referenca:</i> <i>RVB</i> <i>-Shënime nga vizita në Institucion</i> <i>- https://www.epoka.edu.al/</i> <i>-Shtojca 2- Regullorja baze</i> <i>-Shtojca 2- Regullorja fakultetit</i> <i>-Shtojca 55- Raporti vjetor i KPSC.</i> <i>-Shtojca 56- Raporti vjetor i Departamentit</i> <i>-Shtojca 57- Raporti vjetor institucional</i> <i>-Shtojca 86- Auditimi i brendshëm 2019. Raportet e mosperputhshmerise</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Universiteti Epoka, nëpërmjet strukturave të tij, që lidhen direkt me vlersimin e cilësisë si Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, (Organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë), shqyrton akte dhe procedura të cilat miratohen nga Senati Akademik. Pas miratimit, zbatimi i këtyre akteve dhe procedurave është i detyrueshëm. GVJ gjykon që procesi i zbatimit ka qenë efektiv dhe ka çuar në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë edhe në PS MP në “Inxhinieri Ndërtimi” <i>Referenca:</i> <i>RVB</i>

	-Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 55- Raporti vjetor i KPSC. -Shtojca 56- Raporti vjetor i Departamentit -Shtojca 57- Raporti vjetor institucional -Shtojca 86- Auditimi i brendshëm 2019. Raportet e mosperputhshmerise		
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në shqyrtim të DVV dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti Epoka organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në takimin me personelin akademik, u pohua që rezultatet e anketimeve ndikonin direkt në ndërgjegjësimin e tyre lidhur me natyrën e gjetjeve dhe motivimin e tyre për tu ngjitur më lart në nivelet e vlerësimit. <i>Referenca:</i> RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Shtojca 19- Politika për përmirësimin e vazhdueshëm të PS -Shtojca 21-Formulari i matjes e vlerësimit të performancës akademike --Shtojca 22- Anketa e vlerësimit të instruktoresve të kursit. -Shtojca 92- Anketa e kënaqësisë së studentëve -Shtojca 93- Formulari i anketes për kënaqësinë e stafit akademik		
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që në Universitetin Epoka politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit MP në Inxhinierinë e Ndërtimit janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" ofruar nga "Univesiteti Epoka"

Pikat e forta dhe afirmime

a. Pika të forta:

- 1) Programi Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" në Universitetin Epoka zhvillohet si ofertë e një institucioni që ka pëlqyeshmëri të lartë për cilësinë e produkteve të tij.
- 2) Programi Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" në Universitetin Epoka synon të përthithë kandidatë, të cilët preferojnë të përfundojnë ciklin e studimeve në këtë institucion për të zhvilluar e thelluar më tej njohuritë e tyre në aspektin praktik duke shfrytëzuar ofertën cilësore të mësimdhënjes dhe cilësinë e lartë të shërbimeve të tij.
- 3) Kurikula e programit Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" është kompozuar dhe realizohet në funksion të kërkesave të tregut të punës vendas e të huaj, çfarë rrit shanset e punësimit të tyre brenda e jashtë vendit.
- 4) Staf i akademik i angazhuar në këtë program studimi duke qenë i angazhuar edhe në programin master shkencor ofron njohuri cilësore në rrafshin praktik, të cilat kërkohen nga tregu i punës.
- 5) Oferta e shërbimeve administrative në universitetin Epoka është e plotë dhe cilësore duke u krijuar studentëve një infrastrukturë jo vetëm komode por edhe stimuluese në realizimin e ciklit të studimeve.
- 6) Vazhdimësia e studimeve nga cikli Bachelor edhe në ciklin e dytë të studimeve si master profesional i inkurajon edhe studentët që nuk plotësojnë kriteret për të vazhduar diplomën e masterit shkencor, të avancojnë më tej studimet duke shfrytëzuar avantazhet që ofron universiteti Epoka si mësimdhënjen në anglisht, bashkëpunimin ndërkombëtar, lidhjet me tregun e punës etj.
- 7) Ofrimi i mësimdhënies në gjuhën angleze ka krijuar kushtet për t'i dhënë këtij programi një profil ndërkombëtar.
- 8) Mundësi komunikimi online me studentët për çdo informacion që ata kanë nevojë lidhur me procesin mësimor, social dhe mundësi këshillimi të tyre për tregun e punës.

Pika të dobta

1. Edhe pse oferta për këtë program studimi është e mirëkompozuar kërkesat për të janë të pakta duke çuar deri në mbyllje të tij. Kjo lidhet, ndër të tjera, edhe me boshllëqet në

kuadrin ligjor për të drejtën e licensimit e cila nuk u jepet studentëve që diplomohen në Master Profesional.

2. Duke marrë në konsideratë që peshën kryesore të financimit të këtij PS e përbejnë tarifat e studentëve, zvogëlimi i numrit të tyre, mund të kërkojë rritjen e tarifës deri në nivel ose të papërballueshëm ose jo interesant në raport me konkurrencën (Standardi IV.5, kriteri 2).

Rekomandime

1. Të rritet pesha e financimeve nga burime të tjera për të lehtësuar ngarkesën financiare në tarifën e studimeve

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master and Level Program "Civil Engineering" provided by "EPOKA UNIVERSITY"

Strengths and affirmations

- 1) The Professional Master Program in "Civil Engineering" at Epoka University is developed as an offer of an institution that has high popularity for the quality of its products.
- 2) The Professional Master's Program in "Civil Engineering" at Epoka University aims to absorb candidates who prefer to complete the cycle of studies at this institution to further develop and deepen their knowledge in a practical aspect by utilizing the quality of teaching and the quality high of his services.
- 3) The curriculum of the Professional Master's program in "Construction Engineering" is composed and realized in function of the demands of the local and foreign labor market, which increases the chances of their employment inside and outside the country.
- 4) The academic staff engaged in this study program, being also engaged in the scientific master's program, offers qualitative knowledge at the practical level, which is required by the labor market.
- 5) The offer of administrative services at Epoka University is complete and qualitative, creating for students an environment that is not only comfortable but also stimulating in the realization of the study cycle.
- 6) The continuation of studies from the Bachelor cycle to the second cycle of studies as a professional master also encourages students who do not meet the criteria to continue the

scientific master's degree, to further advance their studies by taking advantage of the advantages that Epoka University offers, such as teaching in English, international cooperation, connections with the labor market, etc.

7) Teaching in English has created the conditions to give this program an international profile.

8) Possibility of online communication with students for any information they need regarding the learning process, social and employment opportunities and their counseling in the labor market.

Weaknesses

1. Although the offer for this study program is well composed, the demands for it are fee, leading to its closure. This is related, among other things, to the gaps in the legal framework for the right to license, which is not granted to students who graduate in the Professional Master.

2. Taking into consideration that the main weight of the funding of this SP is comprised of student fees, reducing their number will require the fee to be increased to a level that is either unaffordable or uninteresting in relation to the competition (Standard IV.5, criterion 2).

Recommendation

1. To increase the weight of funding from other sources to ease the financial burden on the study fee

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

